



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 49/2019 (JR)  
Datë 09.10.2019

Vendim nr. 16 (JR)  
Datë 23.06.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.06.2021, ditën e mërkurë, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 172, datë 27.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 172, datë 27.06.2019, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*
2. Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, dhe arriti në përfundimin se:

**2.1** *Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “vetting” dhe në deklaratat periodike dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse – mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me pasuritë, sidomos për sa u përket burimeve financiare nga biznesi i bashkëshortit – sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës.*

**2.2** *Në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues, në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të ngritura, nuk i konsideron të mjaftueshme elementet në nivel indicie dhe dyshimesh në dispozicion, për të konkluduar dhe konsideruar subjektin e rivlerësimit, të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

**2.3** *Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura dhe shkelje procedurale, për shkak të të cilave nuk arrin nivelin kualifikues, të kërkuar sipas gurmës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe për rrjedhojë duhet aplikuar pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**2.4** *Nga vlerësimi tërësor dhe kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

*Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.*

3. Komisioni, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “c” të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3, 4, 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendosi *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*

### II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 172, datë 27.06.2019, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, e cila kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë.
5. Shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në: *i) procesi i rivlerësimit për subjektin Alketa Nushi nuk është një*

*proces i rregullt ligjor, parim që gjen mbrojtje nga neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës Shqiptarisë; ii) mosrespektimi i disa parimeve të Kodit të Procedurave Administrative gjatë procesit të rivlerësimit; iii) procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Alketa Nushi për aftësitë profesionale është në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 etj.*

6. Shkaqet ankimore lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë:

**6.1** Lidhur me tokën vreshtë me sipërfaqe 1.600 m<sup>2</sup> dhe ullishtë me sipërfaqe 1.500 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, Vlorë:

- i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, pretendon në ankim se në deklaratën e pasurisë “vetting” u ka qëndruar besnike dokumenteve të lëshuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për pasuritë e regjistruara në emër të nënës si kryetare e familjes bujqësore.
- ii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mbi tokën vreshtë me sipërfaqe 1.600 m<sup>2</sup> dhe ullishtë me sipërfaqe 1.500 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, Vlorë, nuk ushtrohet ndonjë e drejtë siç mund të jetë përdorimi, duke qenë se vëllai i subjektit jeton jashtë vendit, nëna për shkak të moshës nuk e ka të mundur fizikisht të punojë tokat e mësipërme, kurse subjekti është larguar nga banesa në fshat që në vitin 1998.
- iii. Vendimi i Komisionit në lidhje me pasuritë e llojit vreshtë me sipërfaqe 1600 m<sup>2</sup> dhe ullishtë me sipërfaqe 1500 m<sup>2</sup> është tërësisht i pambështetur në ligj dhe prova. Këto pasuri janë përfutur për shkak të ligjit kur subjekti ka qenë e mitur dhe nuk lidhen me ushtrimin e funksionit si prokurore.

**6.2** Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit privat:

- i. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kërkuar riçeljen e hetimit administrativ me qëllim që të merren si prova *faturat e thjeshta tatimore* për vitet 2009 e në vazhdim, me qëllim përfshirjen në analizën financiare, kërkesë e paraqitur në Komision më 21.06.2019, për të cilën nuk ka pasur një vendim të arsyetuar.
- ii. Sipas subjektit në ankim, Komisioni arsyeton se ka analizuar këto fatura të thjeshta tatimore, por pa treguar mënyrën se si është bërë kjo analizë dhe pa ia nënshtruar debatit në seancë dëgjimore, pra në shkelje të parimeve bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit të Procedurave Civile, i bazuar në parimin e kontradiktoritetit.
- iii. Subjekti pretendon se Komisioni analizën e faturave të thjeshta tatimore, e ka bërë si një veprim të thjeshtë aritmetik duke mbledhur shumat e faturave tatimore dhe duke nxjerrë shumatoren për 3 vjet (2009 - 2011), duke arritur kështu në konkluzionin se ka një diferencë të padeklaruar dhe të patatuar prej 3.689.600 lekësh. Është tërësisht e pakuptueshme se si është arritur në këtë përfundim dhe çfarë ka shërbyer si bazë krahasimi për të arritur në këtë konkluzion.
- iv. Subjekti pretendon se në frymën e Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, qëllimi i procesit të rivlerësimit është verifikimi nëse subjektet kanë deklaruar saktë apo në mënyrë të plotë pasuritë e tyre, dhe jo evidentimi i pasaktësisë në plotësimin e deklaratave të interesave periodikë/vjetorë, për sa kohë që këto pasuri justifikohen ligjërisht dhe burimi i ligjshëm i këtyre pasurive shpjegohet dhe provohet bindshëm.

7. Shkaqet ankimore lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konsistojnë:

**7.1 Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të A. S. dhe A. A. (alias A. D.) etj.:**

i. Subjekti pretendon se masat e sigurimit personal ndaj shtetasit A. S. dhe A. A. *alias* A. D. kanë qenë në përputhje me kushtet dhe kriteret të parashikuara respektivisht nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurave Penale, duke marrë parasysh një sërë rrethanash të tjera si rrezikshmëria e autorit, moshë, rrethanat familjare dhe shoqërore, shkalla e fajësisë etj., siç janë arsyetuar në vendimin unifikues nr. 7 të vitit 2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pika 11, paragrafi 4, lidhur me rastet e rrezikut për “eliminimin” e provave, të ikjes, si dhe me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.

ii. Arritja e marrëveshjes së pajtimit midis shtetasit A. S. dhe A. A., duke pasur parasysh dhe rrezikshmërinë jo të lartë shoqërore të veprës penale (neni 300/1 i K.Penal që parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet), si dhe faktin se nuk kishte më rrezik për agravimin e konfliktit, sipas subjektit është parë e arsyeshme të pranohej kërkesa për zëvendësim mase sigurimi personal, kërkesë e gjetur në përputhje me ligjin dhe e pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2017.

iii. Subjekti i rivlerësimit e ka vlerësuar të rëndësishme marrëveshjen e arritur midis palëve, pasi në momentet e para është dyshuar se shtetasi K. S., që është djali i shtetasit A. S., ka plagosur në këmbë shtetasin A. A., pra duke mos qenë thjesht pronar i lokalit ku ka ndodhur konflikti. Për sa i përket faktit se akuza për plagosje të lehtë ndaj shtetasit K. S. në dëm të shtetasit A. A., nga një sërë veprimesh hetimore nuk ka rezultuar e provuar, ndërsa në fazën e parë kur është urdhëruar regjistrimi i këtij procedimi penal ka pasur dyshime të arsyeshme se autor i plagosjes së shtetasit A. A. ka qenë pikërisht shtetasi K. S.

iv. Kjo masë sigurimi ka rezultuar proporcionale, duke pasur parasysh se në vazhdimësi nuk ka pasur më konflikt midis palëve. Gjithashtu nuk ka rezultuar që pas zëvendësimit të masës së sigurimit shtetasi A. A. të ketë vënë në rrezik marrjen e ndonjë prove, aq më tepër që ky shtetas në lidhje me ngjarjen në fjalë nuk ka bërë as kallëzim penal dhe, për këtë arsye, ai është kallëzuar për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe më konkretisht ka deklaruar se nuk i njihë personat që është konfliktuar.

v. Subjekti i rivlerësimit pretendon se formulimi i akuzave në ngarkim të shtetasve A. S. dhe A. A. ka qenë i drejtë dhe nuk është bërë asnjë lloj favorizimi ndaj tyre, çështja vazhdon të jetë ende në shqyrtim.

vi. Sipas subjektit në ankim, vendimi nr. {\*\*\*}, i datës 23.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal dhe plotësimin e hetimeve, është aspekt procedural dhe nuk prezumon mangësi profesionale, mungesë paanësie apo qëndrim favorizues, për sa kohë që nuk është bërë me keqbesim, por është një mjet kontrolli nga gjyqtari i seancës paraprake mbi veprimtarinë e prokurorit, ashtu siç janë shkallët më të larta të gjyqësorit për ato më të ulëta.

**7.2 Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit F. N.:**

i. Subjekti pretendon se hetimi i këtij procedimi penal ka qenë korrekt, rigoroz dhe në mbështetje të plotë me ligjin material dhe procedural penal. Ky procedim penal ka kaluar të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimmarrja e subjektit është konsideruar e drejtë, bazuar në ligj dhe në prova.

ii. Vendimi i drejtuesit të Prokurorisë për shfuqizimin e vendimit të subjektit në lidhje me këtë procedim penal nuk është gjetur i bazuar nga asnjë prej gjykatave (pasi ky procedim penal

në vazhdimësi, pas shfuqizimit, është ndjekur nga vetë drejtuesi i prokurorisë). Komisioni nuk e ka konsideruar të rëndësishme të pasqyroste këtë fakt në vendim, aq më tepër që vendimmarrja e subjektit në lidhje me formulimin e akuzave ndaj të pandehurit F. N. është gjetur e bazuar nga të gjitha shkallët e gjyqësorit.

### **7.3 Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit S. Xh.:**

- i.* Subjekti pretendon në ankim se është tërësisht i pakuptueshëm fakti që supozohet, se subjekti ka favorizuar të pandehurin, pasi ka qenë vetë prokurorja (subjekti i rivlerësimit) që ka ngritur akuzën e “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe për këtë procedim penal ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.
- ii.* Subjekti pretendon se shfuqizimi i vendimeve të prokurorit më të ulët nga prokurori më i lartë ka qenë një aspekt procedural që nuk nënkupton *a priori* mungesë profesionalizmi apo favorizim të subjekteve të procedimit penal. Nëse Prokurori i Përgjithshëm, pas kontrollit të kësaj dosjeje, do të evidentonte mungesë profesionalizmi apo favorizimin e të pandehurit, do të procedonte me fillimin e procedimit disiplinor ose penal, që në rastin konkret nuk ka ndodhur, madje për vitin 2015, subjekti është vlerësuar “Shumë mirë”.
- iii.* Sa i përket masës së sigurimit për këtë shtetas, subjekti informon se ka kërkuar që masa e sigurimit personal ndaj shtetasit S. Xh. të kërkohej në seancë gjyqësore, pra nuk ka qenë kundër caktimit të masës së sigurimit ndaj këtij të pandehuri. Masa e sigurimit personal në fazën e gjykimit nga drejtuesi i prokurorisë është kërkuar pas zhvillimit të tri seancave gjyqësore dhe konkretisht në seancën gjyqësore të datës 26.06.2015.
- iv.* Sa i përket mungesës së urdhrit të kërkimit, subjekti pretendon se njoftimi për këtë të pandehur është bërë në përputhje me nenin 142 të Kodit të Procedurës Penale pasi nga verifikimi i sistemit TIMS, ishte larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- v.* Subjekti pretendon se, sa rezulton nga dosja gjyqësore me nr. {\*\*\*}, datë 23.04.2015 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nuk ka një urdher kërkimi për të pandehurin, pavarësisht se një nga shkaqet e shfuqizimit të vendimit të subjektit ka qenë mungesa e urdhrit të kërkimit për këtë të pandehur dhe gjykata nuk e ka gjetur të metë procedurale pasi, ashtu sikundër pretendon subjekti, njoftimi për këtë pandehur është bërë në përputhje me nenin 142 të Kodit të Procedurës Penale.
- vi.* Subjekti pretendon se drejtuesi i prokurorisë, përpara se të shfuqizonte vendimmarrjen e subjektit, duhet të bënte të ditur për veprimet hetimore që nuk ishin kryer dhe që mendonte se duheshin kryer dhe vetëm nëse subjekti s’do t’i pranonte, mund të dispononte me shfuqizimin e vendimit.
- vii.* Pas shfuqizimit të vendimit, dosja penale është dërguar për gjykim me të njëjtën akuzë, mbi të njëjtat fakte e prova, me akte të përpiluara dhe nënshkruara nga subjekti, dhe i pandehuri është deklaruar fajtor për të njëjtën akuzë si të ngritur nga subjekti, për të njëjtat fakte penale dhe bazuar në të njëjtat prova si ato të mbledhura nga subjekti gjatë fazës së hetimeve paraprake.

### **III. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet ankimore me natyrë procedurale**

- 8.** *Subjekti pretendon se Komisioni nuk përbën një gjykatë të pavarur, të paanshme, pasi e njëjta trupë gjyqësore bën hetimin administrativ dhe, në bazë të rezultateve, merr edhe vendim. Komisioni, sipas subjektit, ka vepruar si një gjykatë e jashtëzakonshme që nuk u është*

*nënshtuar detyrimeve të Kushtetutës dhe KEDNj-së, duke mos respektuar rregullat e procesit administrativ dhe ligjit nr. 84/2016.*

Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, se kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht dhe në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kreu VII “Procedura e rivlerësimit” i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Sa i përket aspektit të funksionimit të organeve që kryejnë procesin e rivlerësimit, është analizuar dhe gjetur në përputhje me të gjitha garancitë e nevojshme për një proces të rregullt ligjor, si nga Gjykata Kushtetuese në paragrafët 38 dhe 67<sup>1</sup> të vendimit nr. 2/2017, nga Komisioni i Venecias<sup>2</sup> dhe në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*<sup>3</sup>, paragrafët 307 dhe 308, ku është konstatuar se mënyra se si funksionojnë institucionet e rivlerësimit përmbush standardet e KEDNj-së. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i papabuar.

9. *Subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimin se procesi i rivlerësimit ndaj Alketa Nushit për vlerësimin e aftësive profesionale ka qenë në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për dy procedime penale të vitit 2017, përkatësisht nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}. Këto procedime penale në kohën kur janë vlerësuar nga Komisioni, kanë qenë ende në fazë gjykimi, si dhe nuk përfshihen në periudhën e vlerësimit të aftësive profesionale, përcaktuar nga ligji nr. 84/2016.*

Në analizë të këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se, referuar parashikimit në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, *vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj*, për të vijuar me parashikimin në pikën 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit *vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.*

Referuar këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, arrihet në përfundimin se periudha 3-vjeçare lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale sa u përket dosjeve të shortuara për këtë qëllim apo të përzgjedhura nga vetë subjekti, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet edhe përtej kësaj periudhe, siç është parashikuar në pikën 4 të këtij neni, *që nga 2006 e në vazhdim*, pa e kufizuar në kohë, përfshirë këtu dhe vitin 2017. Në të njëjtën logjikë, vijon më pas dhe parashikimi në pikën 1 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, që lidhet me denoncimet e publikut, sipas të cilit *çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. Si rrjedhojë, këto parashikime ligjore nuk kufizojnë denoncimet vetëm në afatin 3-vjeçar të përcaktuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, por nëse ka indicie apo të dhëna mbi fakte të cilat afektojnë vlerësimin e institucioneve të rivlerësimit mbi tri kriteret, atëherë këto institucione kanë detyrimin ligjor për t'i marrë në shqyrtim dhe për t'i vlerësuar. Në rastin objekt gjykimi, analizimi i dosjeve penale të marra në vlerësim, është iniciuar nga agjencitë ligjzbatuese të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji i posaçëm për të ndihmuar institucionet e rivlerësimit në veprimtarinë e tyre për*

<sup>1</sup> [https://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)

<sup>2</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e)

<sup>3</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%7B%22document%22,%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D>

kryerjen e procesit të rivlerësimit. Sa më sipër, vlerësimi i dy procedimeve penale që i përkasin vitit 2017<sup>4</sup>, nuk përbën shkelje kushtetuese apo ligjore siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

10. *Sipas subjektit në ankim, është i pakuptueshëm fakti se si raporti i rivlerësimit të aftësive profesionale nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përcjellë në Komision më datë 22.05.2019 dhe është përfshirë në relacionin e rezultateve të hetimit administrativ ende pa u miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në seancën plenare të datës 12.06.2019. Ky fakt është tregues se i gjithë procesi i rivlerësimit dhe vendimmarrja e Komisionit kanë qenë të paracaktuara dhe përfshirja e këtij raporti është bërë vetëm formalisht për të krijuar përshtypjen e respektimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, çka bën që të vihet seriozisht në dyshim dhe të pretendohet për shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*

Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se më datë 07.06.2019, Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ, ku në paragrafin “III - Rivlerësimi i Aftësive Profesionale”, citohet: *Komisioni ka administruar Raportin e përcjellë pranë Komisionit në datën 22.05.2019 dhe të përpiluar nga KLP për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit [...].* Ndërkohë që raporti është miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2019, “Për miratimin e raportit për analizimin e aftësive profesionale të prokurores Alketa Nushi”, dhe është përcjellë në Komision përmes shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2019.

Pavarësisht konstatimeve më sipër, që *relacioni mbi rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Nushi*, i është përcjellë subjektit përpara se Komisioni të kishte administruar raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ky fakt nuk afekton vlefshmërinë e vendimit të Komisionit. *Së pari*, siç bëhet me dije gjatë seancës dëgjimore të datës 25.06.2019, nga relatori i trupit gjykues në Komision, *Komisioni ka administruar raportin e përpiluar nga KLP, i cili ka analizuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit znj. Alketa Nushi. Fillimisht raporti në fjalë, sipas praktikës së zakonshme të komunikimit midis KLP dhe KPK është përcjellë pranë këtij të fundit në rrugë elektronike dhe më pas ai është përcjellë fizikisht. Formulimi i rezultateve të hetimit përpara se të mbërrinte fizikisht ky raport nuk rezulton që të ketë cenuar të drejtat e subjektit apo të ketë pasqyruar ndonjë pasojë për të.*

*Së dyti*, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, ka kryer një proces të pavarur vlerësimi, duke administruar dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se *vendimmarrja e Komisionit ka qenë e paracaktuar dhe përfshirja e këtij raporti është bërë vetëm formalisht për të krijuar përshtypjen e respektimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor*, gjendet i pabazuar.

11. *Procedura e ndjekur nga Komisioni për hetimin e kryer për kontrollin e figurës përbën shkelje të procesit të rregullt, pasi janë administruar dy raporte nga DSJK-ja. Kërkesa e bërë nga Komisioni, si dhe përgjigjja e dërguar nga DSJK-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.07.2018, janë në kundërshtim me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 34, 38, pika 4 dhe 39, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

Lidhur me vlerësimin e kontrollit të figurës, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka administruar fillimisht raportin e Grupit të Punës, përcjellë nga DSJK-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, ku është konstatuar *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Th. Nushi*. Në këtë raport, sqarohet se ai është përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 autoriteteve verifikuese. Pas kërkesës së Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë 12.07.2018, DSJK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.07.2018, përcjell raportin e Grupit

<sup>4</sup> Trajtuar në pikën 59 të këtij vendimi.

të Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, duke ndryshuar konstatimin nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Alketa Th. Nushi (Nushaj).

Në pikën iv) të paragrafit B të vendimit, Komisioni shprehet se, bazuar në provat dhe dokumentet që disponon, si dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja, vlerësimi i kryer nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe se informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera, që lidhen me integritetin, nuk janë të bazuara mjaftueshëm për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.

Komisioni, më tej në vendim, arsyeton se, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk krijon bindjen për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij, dhe se konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, por ato mund të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të rivlerësimit.

Në konkluzionin përfundimtar, Komisioni shprehet: Në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të ngritura, nuk i konsideron të mjaftueshëm elementët në nivel indicie dhe dyshimesh në dispozicion, për të konkluduar dhe konsideruar subjektin e rivlerësimit, të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, është dhënë në bazë të nenit 61, pika 3, për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, dhe pikave 4 dhe 5 të këtij neni, pra Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, për sa i përket kriterit të kontrollit të figurës. Për rrjedhojë, pretendimet e ngritura nga subjekti për këtë kriter rivlerësimi, nuk janë të bazuara.

12. Subjekti pretendon në ankim se në asnjë moment nuk është njoftuar se afati kohor për të dhënë shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të ketë qenë brenda datës 18.06.2019, fakt për të cilin është vënë në dijeni vetëm nga vendimi i arsyetuar i Komisionit. Gjithashtu nuk i është bërë e njohur e drejta për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në analizë të këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se në komunikimin nëpërmjet postës elektronike (e-mail) të datës 19.06.2019, Komisioni i drejtohet subjektit, duke i bërë me dije se: 1. Në e-mail-in tonë të datës 7/6 që e kemi nisur (në të njëjtën adresë) edhe në datën 11 qershor, në shkronjën "g" është specifikuar qartë afati që ju kishit deri në datën 18/6 për të paraqitur prova dhe shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit administrativ që ju ishin njoftuar me të njëjtin e-mail [...] 3. Lidhur me kohën shitesë që ju keni kërkuar, për të paraqitur shpjegimet dhe provat tuaja, mbi rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues vendosi që ta zgjasë atë deri në orën 14:00 të datës 24/06/2019 [...]. Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore, relatori i trupit gjykues është shprehur se trupi gjykues vlerësoi kërkesën e saj (referuar subjektit) dhe më datë 18/06/2019, vendosi të zgjasë afatin për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave nga znj. Alketa Nushi, nga data 18.06.2019 që ishte parashikuar më herët deri në datën 24/06/2019. Gjatë seancës dëgjimore të datës 25.06.2019, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur shqetësim lidhur me komunikimin që ka pasur me Komisionin gjatë hetimit administrativ, nuk ka paraqitur pretendime apo ankesa lidhur me pamjaftueshmëri të kohës së vënë në dispozicion nga Komisioni për depozitimin e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në kushtet kur Komisioni, me kërkesë të subjektit, ka zgjatur afatin e vënë në dispozicion për depozitimin e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit me 5 ditë të tjera, bën që pretendimi i ngritur në ankim të jetë i pasaktë dhe i pabazuar.



Lidhur me të drejtën për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se më datë 12.06.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, është njohur me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (2 CD) të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, për të cilën është nënshkruar edhe deklarata nga vetë subjekti, ku konfirmon se u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj në CD, me shënimin: *Ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që m'u vunë në dispozicion.* Më datë 18.06.2019, Komisioni i dërgon subjektit të rivlerësimit disa denoncime, pjesë e dosjes që subjekti kishte parë, por që për probleme teknike nuk kanë qenë edhe në format elektronik, në CD-në e marrë pranë Komisionit. Sa i përket informacionit të përcjellë nga organet ligjzbatuese, të cilat klasifikohen “sekret”, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit është njohur me raportin mbi kontrollin e figurës, përcjellë nga DSIK-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.07.2018, të deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së<sup>5</sup> nr. {\*\*\*}, datë 20.07.2018. Bazuar në jurisprudencën<sup>6</sup> e Kolegjit, si dhe me konsideratë qëndrimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin Regner kundër Republikës Çeke, është shprehur: *Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuesi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjykimt bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ishin balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë. [...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...]. Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...]* – ku në përfundim të këtij vendimi, edhe pse dokumentacioni i klasifikuar nuk i ishte dhënë kërkuesit për t'u njohur me të, nga gjykata (GJEDNJ) konkludohet se nuk ka shkelje, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë subjektit të rivlerësimit, siç është arsyetuar në pikën 11 më sipër në këtë vendim, nuk i ka ardhur asnjë pasojë në kuadër të kontrollit të figurës, mosnjohja me informacionin e klasifikuar sekret nuk ka cenuar të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

13. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është diskriminuar pasi në pyetësorin e dytë nuk i janë kërkuar shpjegime mbi kriterin e pasurisë si për subjektet e tjera, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni heton të gjitha faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe mënyra se ku fokusohet hetimi është individuale, pasi rrethanat dhe faktet mund të jenë të ndryshme për subjekte të ndryshme. Nga analizimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është dërguar pyetësori standard më datë 04.04.2018 (*e-mail*), ashtu si të gjithë subjekteve të tjera që i nënshtrohen këtij procesi. Më pas i dërgohet pyetësori shtesë më datë 22.02.2019, pyetjet e të cilit kanë konsistuar në shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga subjekti dhe personi i lidhur, shpenzimet e mobilimit të apartamentit, lëvizjet të llogarive bankare, shumat prej 2.000 eurosh dhënë si ndihmë ekonomike të pakthyeshme nga nëna e subjektit, dhe 2.000 euro

<sup>5</sup> Akronim për “Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

<sup>6</sup> Shih vendimin nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paragrafi 29.1.

dhuruar nga motra e bashkëshortit. Pra, pothuajse të gjitha pyetjet lidhen pikërisht me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Por edhe nëse pyetjet do të kishin konsistuar në vlerësimin e dy kriterëve të tjerave, përsëri ky fakt nuk provon diskriminim, pasi Komisioni në pyetësorin shtesë, ngre ato pyetje për të cilat ka nevojë për sqarimin e rrethanave e fakteve gjatë hetimit administrativ, para përgatitjes së rezultateve të këtij hetimi. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

14. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se në rastin konkret, ka shkelje të së drejtës së respektimit të jetës private parashikuar nga neni 8, paragrafi 2 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, pasi procedura dhe vendimi i Komisionit janë dhënë në shkelje flagrante të ligjit dhe provave dhe ky vendim është reflektuar jo vetëm në pakësimin e të ardhurave, por dhe dëmtimin e rëndë të reputacionit profesional, si dhe për shkak të pasojave të parashikuara në ligj për përjashtimin nga sistemi i drejtësisë.*

Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se neni 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikon se:

*1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.*

Subjekti i rivlerësimit në ankim, nuk ka përcaktuar se cili veprim i Komisionit ka shkelur në mënyrë flagrante ligjin, kur Kushtetuta dhe ligji i kanë pajisur institucionet e rivlerësimit me të gjithë tagrat për të vlerësuar të tria kriteret e rivlerësimit, të pasurisë, figurës dhe aftësiwe profesionale, duke finalizuar procesin me konfirmim në detyrë ose marrjen e masave disiplinore sipas parashikimeve ligjore. Nga verifikimi i procedurës së rivlerësimit të kryer në Komision, trupit gjykues nuk i rezultoi shkelje e parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe as shkelje flagrante e ligjit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në një situatë të ngjashme në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*,<sup>7</sup> është shprehur se: *Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i ligjit 84/2016, siç parashikohet në nenin 1, është të “garantojë funksionimin e duhur të shtetit ligjor, pavarësinë e vërtetë të sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” [...]* Gjykata Kushtetuese shtoi më tej se çdo kufizim i vendosur nga ligji 84/2016 justifikohet nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, i cili, nga ana tjetër ishte i lidhur me interesat e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve. [...] Në këto rrethana, GjENDj nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkuar në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 2 [...] Gjykata konsideron se, në rrethana të tilla, një reformë në sistemin e drejtësisë që përfshin rivlerësimin e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë i përgjigjet “nevojës së ngutshme shoqërore” [...] Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprinë miratimit të ligjit 84/2016, siç theksohet gjithashtu në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tre kriteret e përcaktuara në ligjin 84/2016 [...] Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkuarës dhe individëve të tjerë të shkarkuar për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të

<sup>7</sup> Shih paragrafët 391 – 413 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

*ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.*

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë procesi i rivlerësimit ka ndjekur procedurën ligjore, pretendimi i subjektit se ka pasur shkelje të së drejtës së jetës private duke dëmtuar rëndë reputacionin profesional, nuk u gjet i bazuar.

15. *Subjekti pretendon se nga interpretimi literal i pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, arrihet në përfundimin se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra sipas kësaj dispozite, jepet kur përmbushen në mënyrë kumulative, deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe kontrollit të figurës.*

Lidhur me këtë shkak ankimor të ngritur dhe në raste të tjera të shqyrtuara nga Kolegji, është mbajtur një qëndrim në jurisprudencën<sup>8</sup> e tij të deritanishme, sipas së cilës nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklaram për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë të qëndrojnë në mënyrë kumulative për të zbatuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Përpos këtij qëndrimi, neni 59, pika 1 e këtij ligji kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të të tria kritereve të rivlerësimit dhe mospërmbushja e njërit prej tyre legjitimon masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

16. *Subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk ka respektuar disa nga parimet e sanksionuara nga Kodi i Procedurave Administrative, si parimi i ligjshmërisë (neni 4), pasi nuk i janë bërë me dije të drejtat në kuadër të procesit të rivlerësimit; parimi i transparencës (neni 5), pasi Komisioni nuk u është përgjigjur kërkesave të subjektit; parimi i dhënies së ndihmës aktive (neni 10), pasi i është mohuar aksesimi në lidhje me komunikimet në rrugë elektronike në lidhje me dërgimin e rezultateve të hetimit, nuk i është bërë me dije afati kohor në dispozicion; mosnjohimi në kohën e duhur mbi kërkesat e paraqitura etj.*

Nga analizimi i akteve të dosjes, si dhe arsyetimi më sipër në këtë vendim, rezulton se Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit duke i garantuar subjektit një proces të rregullt ligjor, si parashikuar në pikën 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit dhe aktet e dosjes së administruar gjatë hetimit, i është dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur shpjegimet e dhëna mbi këto rezultate pas kalimit të barrës së provës, është dëgjuar në seancë dëgjimore, duke i vënë në dispozicion kohën e nevojshme, si dhe nuk rezulton që Komisioni të ketë shkelur ndonjë nga parimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative që do të cenonte procesin e rregullt ligjor në kuadër të rivlerësimit. Nga analizimi i akteve të fashikullit, rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2018, trupi gjykues i Komisionit vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit, kjo procedurë përfundoi më datë 25.06.2019, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore, pra procedura e rivlerësimit për subjektin ka zgjatur rreth 15 muaj). Fakti i fillimit të hetimit administrativ i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me *e-mail*, më datë 04.04.2018, në adresën elektronike [alketa.nushi@pp.gov.al](mailto:alketa.nushi@pp.gov.al), ku i është dërguar dhe pyetësori standard duke i vënë në dispozicion një periudhë prej 10 ditësh. Në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti shprehet se: *pyetësorit të dërguar nga ana juaj në adresën time të e-mail-it [Alketa.Nushi@pp.gov.al](mailto:Alketa.Nushi@pp.gov.al), i përgjigjem si më poshtë vijon.* Të njëjtën gjë subjekti i rivlerësimit shpreh dhe në përgjigjet e pyetësorit shtesë, të depozituar në Komision më datë 04.03.2019. Sa u përket rezultateve të hetimit administrativ, ato i janë përcjellë subjektit më datë 07.06.2019 po në adresën elektronike zyrtare. Ashtu siç arsyetohet në vendimin nr. 172, datë 27.06.2019 të Komisionit [faqe 2, pika vi]: *Në mungesë të një përgjigjeje nga subjekti – edhe pse ishte detyrim i saj të verifikonte dhe të shikonte adresën zyrtare të e-mail-it – pasi znj. Alketa Nushi,*

<sup>8</sup> *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 8, datë 16.04.2019, paragrafi 79; nr. 10, datë 19.11.2018, paragrafi 65; nr. 3, datë 26.01.2021, paragrafi 17.*

*e cila u shpreh se nuk i kishte marrë rezultatet e nisura nga Komisioni, në datën 11.06.2019 u kontaktua telefonikisht nga sekretarja gjyqësore – po në atë datë iu rinisën rezultatet, në po të njëjtën adresë zyrtare e-mail-i. Këtë herë subjekti i rivlerësimit e konfirmoi marrjen e tyre.*

Po nëpërmjet adresës elektronike [Alketa.Nushi@pp.gov.al](mailto:Alketa.Nushi@pp.gov.al), datë 19.06.2019, subjekti i rivlerësimit i drejtohet Komisionit: *Rezulton se më keni dërguar rezultatet paraprakë të hetimit administrativ në e-mail-in zyrtar, në datë 11.06.2019, ora 19:03 min. Kam konstatuar se nuk më keni lënë afat për parashtrimet dhe për paraqitjen e provave.* Nëpërmjet këtij e-mail-i subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kohë për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave. Për të cilën si arsyetuar më sipër, nga Komisioni i është shtyrë afati i dorëzimit të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ deri më datë 24.06.2019. Nga shqyrtimi i komunikimeve elektronike të subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit, në adresën elektronike zyrtare, në disa raste e-mail-i është marrë nga subjekti, në disa raste ka ardhur njoftimi: *delivery to these recipient or groups is complete, but no delivery notification was sent by the destination server.* Edhe pse subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes në kontrollin e postës elektronike gjatë procesit të rivlerësimit [neni 46, pika 3 e ligjit nr. 84/2016<sup>9</sup>], në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është njohur me pyetësorët dhe rezultatet e hetimit administrativ, i është dhënë kohë e mjaftueshme për t'u përgjigjur, dhënë shpjegime e prova, është njohur me aktet e dosjes gjyqësore, si dhe i është vënë në dispozicion gjatë seancës dëgjimore koha e nevojshme për të dhënë parashtrimet e saj, çka bën që pretendimi i saj të gjendet i pabazuar, për më tepër kur ky pretendim nuk u ngrit nga subjekti gjatë seancës dëgjimore në Komision.

17. Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes së njoftimit nga Kolegji për shqyrtimin në dhomë këshillimi të çështjes nr. 49/2019, ka paraqitur në Kolegj më datë 11.06.2021, protokolluar me nr. {\*\*\*}, parashtrime shtesë me shkrim, 5 ditë para seancës gjyqësore, lidhur me shkaqet e ankimit, sipas parashikimit në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
18. Nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cili parashikon rastet kur një gjykim administrativ në gjykatën e apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike. Për të gjitha arsyet e analizuara më sipër, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë çështjen nr. 49/2019 (JR) që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet ankimore lidhur me kriterin e pasurisë**

19. Komisioni, lidhur me këtë kriter vlerësimi, ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “vetting” dhe në deklaratat periodike dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse – mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me pasuritë, sidomos për sa i përket burimeve financiare nga biznesi i bashkëshortit – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
20. Trupi gjykues analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit mbi konkluzionet e Komisionit, lidhur me pasuritë, tokat e ndodhura në fshatin {\*\*\*}, Njësia Bashkiake {\*\*\*}, Bashkia Vlorë, të përfituara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, si anëtare e

---

<sup>9</sup> Neni 46, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit”.

familjes bujqësore, më konkretisht tokë vreshtë 1600 m<sup>2</sup> dhe ullishte 1500 m<sup>2</sup>, si dhe mbi të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik të bashkëshortit të subjektit.

21. Lidhur me tokën, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka kryer një deklaram të pamjaftueshëm lidhur me tokën vreshtë me sip. 1.600 m<sup>2</sup>, të ndodhur në {\*\*\*}, Vlorë, me pjesë takuese 33%, dhe ullishtë me sip. 1.500 m<sup>2</sup>, me të njëjtën vendndodhje dhe pjesë takuese, të përfituara si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Ky konkluzion rrjedh nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që të deklaronte të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi, në posedim apo në përdorim, dhe dy pasuritë në fjalë, për pjesën takuese 33%, sigurisht që kanë qenë në posedim të subjektit, së paku de jure, duke qenë se këto janë përfituar nga ligji nr. 7501/91, dhe nuk rezultojn as të jenë tjetërsuar dhe as të jenë në posedim të ndonjë shoqërie apo individit jashtë familjes bujqësore. Komisioni çmon se mospunimi, shfrytëzimi, apo mospërfitimi i fryteve nga një send – përtej faktit se kjo mund të jetë realizuar edhe në mënyrë indirekte – nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për të deklaruar posedimin e tij.

22. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2008 dhe deklaratës së pasurisë vetting, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon.

22.1 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më 08.12.2008, pasuritë e fituara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, të ndodhura në fshatin {\*\*\*}, Vlorë, subjekti i rivlerësimit deklaroi:

1. Arë, në sipërfaqe 8987 m<sup>2</sup> [...] pjesa takuese 33%.
2. Vreshtë, në sip. 1600 m<sup>2</sup> [...] pjesa takuese 33%.
3. Ullishte në sip. 1500 m<sup>2</sup> [...] pjesa takuese 33%.

22.2 Në deklaratën e pasurisë vetting të vitit 2017, deklaroi:

1. Tokë arë, sipërfaqe 1302 m<sup>2</sup> [...], pjesa takuese 33,3%.
2. Tokë arë, sipërfaqja 2655 m<sup>2</sup> [...], pjesa takuese 33,3%.
3. Tokë arë, sipërfaqja 3600 m<sup>2</sup> [...], pjesa takuese 33,3%.
4. Tokë arë, sipërfaqja 1607 m<sup>2</sup> [...], pjesa takuese 33,3%.
5. Tokë truall, sipërfaqja 250 m<sup>2</sup> [...], pjesa takuese 33,3%.

23. Referuar dokumentacionit shoqëruar të deklaratës së pasurisë vetting, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. regjistri {\*\*\*}, Rrethi Vlorë, fshati {\*\*\*}, datë 6.3.1993, familjes së N. N. (nënës së subjektit) i jepet në pronësi tokë gjithsej 12 087 m<sup>2</sup>, e cila përbëhet nga 8987 m<sup>2</sup> tokë arë, 1600 m<sup>2</sup> vreshtë, 1500 m<sup>2</sup> ullishte. Pra, rezultojn që në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008, subjekti të ketë deklaruar pasuritë sipas dokumentit AMTP. Referuar certifikatave për vërtetim pronësie (bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting), të lëshuara në vitin 2009 nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të N. N. (pjesa: familjare), rezultojn: i) tokë arë, z.k {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, sipërfaqe 1302 m<sup>2</sup>; ii) tokë arë, z.k {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*} me sipërfaqe 2655 m<sup>2</sup>; iii) tokë arë, z.k {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, sipërfaqe 3600 m<sup>2</sup>; iv) tokë arë, z.k {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, sipërfaqe 1607 m<sup>2</sup>; v) truall, z.k {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>. Ky informacion është konfirmuar nga ZVRPP Vlorë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.01.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

24. Nisur nga fakti që subjekti ka deklaruar sipas dokumentacionit justifikues ligjor të kohës, konkretisht AMTP-së, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2008 dhe më pas sipas certifikatave për vërtetim pronësie lëshuar nga ZRPP Vlorë, në deklaratën e pasurisë vetting, si dhe në kushtet kur nuk rezultojn që pasuritë vreshtë me sipërfaqe 1.600 m<sup>2</sup> dhe ullishtë me sipërfaqe 1.500 m<sup>2</sup>, të ndodhura në {\*\*\*}, Vlorë, të jenë në përdorim të

subjektit të rivlerësimit apo të jenë tjetërsuar dhe të ardhurat të kenë shërbyer si burim financiar për krijimin e pasurive të tjera, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhe mi në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarin lidhur me këto pasuri.

25. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik, dhe analizës financiare të kryer, Komisioni ka arritur në këto konkluzione:

- i. Në vijim të analizës së kryer lidhur me burimet financiare dhe me deklarin ndërvite të subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, dhe familja e saj, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar investimet dhe shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara;
- ii. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se subjekti dhe personi i lidhur me të, kanë kryer deklarin të pamjaftueshme vjetore për periudhën 2009-2015, duke deklaruar të ardhura neto më të lartë nga sa ka rezultuar nga dokumentacioni provues i administruar nga Komisioni;
- iii. Komisioni vlerëson se pasi janë analizuar dhe përlllogaritur të gjitha faturat e paraqitura nga vetë subjekti – për të provuar xhiron e biznesit të bashkëshortit të vet – ka rezultuar se deklarin e të ardhurave, të kryera pranë organeve tatimore nga ky biznes, nuk përkojnë me ato reale, pasi së paku në tre vjet (2009 -2011), nuk janë deklaruar për efekt të tatimeve mbi 3.6 milion lekë. Ky konkluzion bazohet në faktin që totali i shumave të deklaruara në këto tre vjet, si qarkullim vjetor, rezulton në vlerën 5.224.400 lekë, ndërkohë që shumatorja e faturave të paraqitura nga subjekti, si xhiro vjetore e këtyre viteve, arrin në një total prej 8.914.000 lekësh, pra me një diferencë të padekluar dhe të patatuar prej 3.689.600 lekësh.
- iv. Trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria e dyfishtë dhe e përsëritur e deklarinëve të të ardhurave nga biznesi i bashkëshortit së subjektit të rivlerësimit [...] së bashku me pamjaftueshmëritë e deklarinëve të disa pasurive të vetë subjektit të deklaruara në deklarinën “vetting” dhe ndërvite, na çon në aplikimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

26. Nga analizimi i deklarinës së pasurisë vetting dhe i deklarinave të interesave privatë periodikë vjetorë (DIPPV), trupi gjykues i Kolegjit, konstaton si vijon.

**26.1.** Në deklarinën e pasurisë vetting, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, te zëri “përshkrimi i të ardhurave”, ka deklaruar: *të ardhura neto pas bilancit të bërë për të gjithë veprimtarinë time ekonomike nga viti 2008 – 2016 si person fizik i regjistruar pranë QKB me nr. nipti {\*\*\*}, me objekt dyqan reklamash (në fushën e printimeve), me adresë në Tiranë, rruga “{\*\*\*}”. Këto të ardhura janë neto dhe janë nxjerrë pas bilancit të bërë për të gjithë veprimtarinë ekonomike nga viti 2008 – 2016. (Ky shpjegim bëhet pasi në deklarinët e mëparshme janë deklaruar të ardhurat totale (bruto), fakt i cili është shpjeguar në vitin 2016 në ILDKPKI. Shuma e të ardhurave neto të krijuara: 2.359.476 lekë.*

**26.2.** Në deklarinat e interesave privatë vjetorë, të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit të subjektit, rezulton të jenë deklaruar:

- në 2009, të ardhurat nga *aktiviteti privat* në shumën 450.000 lekë;
- në 2010, të ardhurat nga *aktiviteti si person fizik* “A. N.”, shuma 600.000 lekë;
- në 2011, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma 1.800.000 lekë;
- në 2012, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma 1.426.000 lekë;
- në 2013, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma 1.540.000 lekë;
- në 2014, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma e të ardhurave neto 700.000 lekë;

- në 2015, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma e të ardhurave neto 249.342 lekë;
  - në 2016, *veprimtari si person fizik në fushën e printimeve*, shuma e të ardhurave neto 127.231 lekë.
27. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni iu drejtua për informacion dhe dokumentacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.04.2018, *për të dhënat tatimore (të ardhurat, fitimet, humbjet, pagesat për sigurimet/tatim mbi të ardhurat personale/tatimin në burim etj., dhe çdo lloj veprimi që përbën të dhënë tatimore) për periudhën nga regjistrimi i subjektit/personit fizik e në vijim.*  
Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2018, nga të dhënat që disponohen në sistemin tatimor C@ts pranë kësaj drejtorie, rezulton i regjistruar subjekti “A. N.” me nr. NIPT {\*\*\*}, me të ardhura të realizuara ndër vite, *për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 nuk disponon deklaratë të ardhurash.* Për vitin 2013, qarkullimi vjetor 1.597.976 lekë dhe fitimi mbas tatimit 250.000 lekë; Për vitin 2014, qarkullimi 700.000 lekë dhe fitimi mbas tatimit 308.400 lekë; për vitin 2015, qarkullimi 777.634 lekë dhe fitimi mbas fitimit 224.342 lekë; për vitin 2016, qarkullimi 596.351 lekë dhe fitimi mbas tatimit 127.231 lekë; për vitin 2017, qarkullimi 131.835 lekë dhe fitimi mbas tatimit 72.445 lekë.
28. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, ka pasur mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara dhe atyre të dokumentuara. Duke qenë se në një sërë deklaramesh periodike janë deklaruar të ardhura më të larta nga të ardhurat e ligjshme të dokumentuara, Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime dhe të paraqesë prova me qëllim qartësimin e fakteve dhe gjetjeve të Komisionit.
29. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe aktet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, duke vlerësuar gjetjet e Komisionit, ka kërkuar: *të administrohen dhe të pasqyrohen në analizën financiare si prova faturat e thjeshta tatimore të lëshuara nga bashkëshorti im për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, 2014 dhe 2015.*
30. Në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, barrën e provës *për të provuar të kundërtën* e rezultateve të hetimit të Komisionit e ka subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i akteve të dosjes, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë depozituar dokument justifikues ligjor që të provojë fitimin neto të realizuar nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit, për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, të deklaruara prej tij në deklaratat e interesave privatë periodikë. Po kështu, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2018, konfirmon se *për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 nuk disponon deklaratë të ardhurash*, pra bashkëshorti i subjektit nuk rezulton të ketë deklaruar pranë organeve tatimore qarkullimin/xhiron vjetore të realizuar për vitet 2009-2012, sipas faturave të thjeshta tatimore për të cilat i ka kërkuar Komisionit riçeljen e hetimit administrativ.
31. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *bashkëshorti ka qenë i regjistruar si person fizik dhe sipas shkresës nr. {\*\*\*}, datë 28.10.2016, të Bashkisë Tiranë (paraqitur me deklaratën “vetting”), rezulton se subjekti A. N. me nr. NIPTI {\*\*\*} ka likuiduar detyrimet për Taksën e Biznesit të vogël nga viti 2008 deri në vitin 2012, sipas qarkullimit vjetor në nivelet nga 0 deri në 2.000.000 lekë. Pra, detyrimet tatimore janë paguar në mbështetje të plotë me ligjin tatimor dhe nuk është e kuptueshme sesi trupi gjykses ka arritur në përfundimin sa më sipër. Nga të dhënat sipas faturave të thjeshta tatimore të depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se për vitin 2009 dhe 2011 qarkullimi/xhironja vjetore të ketë qenë më shumë se 3*

milionë lekë dhe jo 0-2 milionë lekë siç pretendon subjekti, duke iu nënshtruar kështu një detyrimi tjetër tatimor.

32. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos marrë në konsideratë të ardhurat sipas *faturave të thjeshta tatimore* të depozituara nga subjekti, të cilat nuk janë deklaruar pranë organeve tatimore, sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës *pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*.
33. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për periudhën nga viti 2008, kur subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, është emëruar në detyrën e prokurores dhe deri në vitin 2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshorti) kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të mbuluar shpenzimet, në vlerën -294.390 lekë. Sipas vlerësimit ligjor të kryer, në analizën financiare në Kolegj janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të provuara me dokumentacion justifikues ligjor. Trupi gjykues, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të përmbushjes së objektit të kontrollit lidhur me kriterin e pasurisë, vlerëson se subjektet e rivlerësimit detyrohen të deklarojnë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, çdo të ardhur të krijuar nga çdo veprimtari apo angazhim. Për sa më sipër, edhe pse subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, në deklaratat e interesave private periodikë prej vitit 2009 - 2015, në kushtet kur në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar saktë këto të ardhura, të konsideruara në analizën financiare të kryer në Kolegj, rezultati i së cilës ka treguar mungesë të burimeve financiare të ligjshme vetëm në vlerën 294.390 lekë, të pamjaftueshme për ta ngritur në shkak shkarkimi, shumica e trupit gjykues vlerësoi se pasaktësitë në deklaratat e interesave private periodikë, të cilat nuk shoqërohen me asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 nuk mund kualifikohen sipas nenit 61 pika 3 e po këtij ligji.

#### **V. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

34. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2019, nga analizimi i tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti që shoqërojnë formularin; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë/ve, ka konkluduar se nuk janë konstatuar mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi. Komisioni ka kryer një proces të pavarur rivlerësimi, duke administruar dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Konstatimet e Komisionit në lidhje me problematikat dhe mangësitë profesionale të evidentuara në to, iu përcollën subjektit me rezultatet e hetimit administrativ duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në përfundim, për këtë kriter, Komisioni arriti në konkluzionin se, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura dhe shkelje procedurale, për shkak të të cilave nuk arrin nivelin kualifikues, të kërkuar sipas germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe për rrjedhojë duhet aplikuar pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.



35. Në parashtrimet e depozituara më datë 11.06.2021, në Kolegj, subjekti pretendon se rivlerësimi i aftësive profesionale për të është bërë në kundërshtim me vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, ligjin nr. 84/2016, ligjin nr. 96/2016, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, pasi Komisioni në gjetjet e evidentuara ka tejkualuar kompetencat duke u shprehur mbi korrektësinë e themelit të çështjes dhe në asnjë rresht të vendimit nuk është arsyetuar se ku qëndrojnë gabimet thelbësore e serioze, si dhe seria e qartë, e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara nga subjekti në këto procedime penale. Sipas pretendimit të subjektit, bazuar në jurisprudencën<sup>10</sup> e Kolegjit, në zbatim edhe të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në kornizën ligjore për rivlerësimin e aftësive profesionale, vlerësimi i themelit të çështjeve nga ana e Komisionit përbën tejkualim të kompetencave të tij kushtetuese e ligjore. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në rastin objekt gjykimi nuk ndodhemi para tejkualimit të kompetencave, pasi Komisioni nuk ka vlerësuar themelin e çështjeve penale, por ka evidentuar mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në dosjet penale, për të cilat dhe instancat ligjore që kanë detyrimin për të vlerësuar veprimtarinë hetimore të subjektit, si drejtuesi i prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm apo gjykata, kanë bërë prezente mangësi profesionale të subjektit.
36. Trupi gjykues i Kolegjit, me konsideratë shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, analizoi aktet e dosjeve penale, të vlerësuara nga Komisioni, që i përkasin konkretisht, procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve A. S. dhe A. A. (alias A. D.), procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve E. D. dhe A. Gj., procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit F. N., si dhe procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit S. Xh.
- Lidhur me dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve A. S. dhe A. A. (alias A. D.)
37. Komisioni, për këtë procedim penal, arriti në përfundimin se *hetimet e këtij procedimi dhe përfundimi i tyre, me formulimin e akuzave [...], nxjerr në pah disa mangësi në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi veprimet dhe mosveprimet hetimore kanë çuar në kryerjen e hetimeve të cunguara dhe në konkluzione të deformuara, me cilësim jo korrekt të veprës penale, së pakunë një rast të formuluar jo në përputhje me faktet e përshkruara në aktet e dosjes në fjalë – siç është evidentuar edhe nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 23.3.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për kthimin pranë Prokurorisë Mat të akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017 dhe plotësimin e hetimeve – vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.*
38. Nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, trupi gjykues konstaton se, më datë 06.09.2017, në lagjen “{\*\*\*}” të qytetit të Burrelit, përpara lokalit në pronësi të shtetasit A. S., ka ndodhur një konflikt ku është përdorur dhe armë zjarri nga ku ka mbetur i plagosur në këmbë shtetasi A. A. (A. D.). Në këtë konflikt janë përfshirë personat: A. S., A. A., K. S., D. S., A. (A.) K., E. P. dhe E. P. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes janë sekuestruar me cilësinë e provës materiale, 7 (shtatë) copë gëzhoja arme zjarri të llojit pistoletë, model 56, kalibër 7.62 mm. Për sqarimin e rrethanave të kësaj ngjarjeje, më datë 6 dhe 7 shtator 2017, janë ushtruar kontrole nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore në banesat e shtetasve A. S., A. A., K. S., D. S., A. (A.) K., E. P. dhe S. K. Sipas procesverbalit të kontrollit të ushtruar më datë 06.09.2017, në një godinë brenda rrethimit të ambienteve në pronësi të shtetasit A. S., që ka

<sup>10</sup> Shih vendimin nr. 16, datë 13.07.2020 (paragrafi 21.3 dhe 21.4), vendimin nr. 20 datë 08.09.2020 (paragrafi 33.7) dhe vendimin nr. 28 datë 23.10.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

shërbyer si njësi shitjeje/prodhimi *fast-food*, magazinë dhe ambiente lojërash për fëmijë, gjatë kontrollit është gjetur dhe sekuestruar një kapsollë detonatore me një fitil zjarrpërcjellës, si dhe është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës një kavanoz qelqi, brenda të cilit u gjet një sasi lëndë narkotike, e dyshuar si e llojit *Cannabis sativa*. Sipas aktit nr. {\*\*\*} të ekspertimit teknik (kapsolle detonatore – fitil zjarrpërcjellës), datë 08.09.2017, është arritur në konkluzionin se: *Objekt ekspertimi (1) është kapsolla detonatorë, prodhim i fabrikuar dhe përdoret për detonimin e lëndëve plasëse dhe aktivizohet me fitil zjarrpërcjellës, konstatohet në gjendje të rregullt teknike. Objekt ekspertimi (2) fitil zjarrpërcjellës, është prodhim i fabrikuar dhe përdoret për aktivizimin e kapsollave detonatore, paraqitet në gjendje të rregullt teknike.*

39. Më datë 08.09.2017, me urdhër të prokurores Alketa Nushi, regjistrohet procedimi penal nr. {\*\*\*}i vitit 2017, duke regjistruar personat që u atribuohet vepra penale:

39.1. A. S., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, si dhe “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

39.2. A. A., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

39.3. K. S., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në mjedise publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, si dhe “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

39.4. D. S., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 274 e 25 i Kodit Penal.

39.5. E. P., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

39.6. A. (A.) K., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në mjedise publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, dhe “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

39.7. E. P., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

39.8. S. K., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

40. Lidhur me kërkesat për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit të subjektit të rivlerësimit, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për shtetasin A. S. është kërkuar të vleftësohet i ligjshëm arresti në flagrancë, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë, të parashikuar nga neni 278/4 dhe “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe të caktohet ndaj tij masa e sigurimit personal “garanci pasurore

në shumën 200.000 lekë”, si dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndërsa për shtetasin A. A., është kërkuar të vleftësohet i ligjshëm arresti në flagrancë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit” të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe të caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg”.

Në vijim të kërkesave të subjektit të rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, vendosi të vleftësojë të ligjshëm “arrestin në flagrancë”, të bërë më datë 07.09.2017, ndaj personit nën hetim A. T. S., për veprat penale të parashikuara në nenet 278/4 dhe 283/1 të Kodit Penal, si dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit, atë të “Garancisë pasurore” në shumën 200.000 lekë dhe atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore dy herë në muaj”, kurse, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, vendosi të vleftësojë të ligjshëm “arrestimin në flagrancë”, të bërë më datë 07.09.2017, ora 03:00, kryer nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Mat, ndaj personit nën hetim A. E. A., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, si dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim, A. E. A., atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, më datë 19.09.2017, me vendimin nr. {\*\*\*}, vetëm 9 ditë pas dhënies së vendimit nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, ka vendosur *pranimin e kërkesës së kërkuarit A. A. si të bazuar në prova dhe në ligj. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “arrest në burg” [...] me masën e sigurimit personal, atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim mori formë të prerë më datë 02.10.2017.*

41. Subjekti i rivlerësimit në ankim, pretendon se masat e sigurimit ndaj shtetasit A. S. dhe A. A. *alias* A. D. kanë qenë në përputhje me kushtet dhe kriteret të parashikuara respektivisht nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurave Penale, duke marrë parasysh një sërë rrethanash të tjera, si: rrezikshmëria e autorit, mosha, rrethanat familjare dhe shoqërore, shkalla e fajësisë etj., siç janë arsytuar në vendimin unifikues nr. 7 të vitit 2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pika 11, paragrafi 4, lidhur me rastet e rrezikut për “eliminimin” e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.
42. Subjekti i rivlerësimit pretendon se masa e sigurimit, e caktuar ndaj shtetasve A. S. dhe A. A. ka qenë proporcionale dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, ku në rastin e A. S. është marrë parasysh edhe fakti që i është gjetur vetëm një kapsollë detonatore, si dhe një sasi prej 0,140 kg lëndë narkotike, e llojit *cannabis sativa*, në një ambient të cilin ai nuk e përdorte prej disa vitesh. Ndërsa për shtetasin A. A. *alias* A. D., është marrë në konsideratë personaliteti i tij, shkalla e fajësisë, rreziku për të parandaluar agravimin e këtij konflikti të filluar prej tij dhe pse vepra nuk ka pasur ndonjë rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe fakti se ky shtetas, më datë 16.11.2012, i njohur në atë periudhë me emrin A. Z., ka qenë prezent, edhe pse jo i përfshirë si autor i veprës, në një konflikt tjetër me armë zjarri në mes të qytetit, ku shtetasi S. N., me të cilin A. A. ishte në të njëjtën makinë, ka qëlluar me armë zjarri dhe si pasojë është plagosur në këmbë shtetasi A. M.
43. Sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur shpjegimeve të dhëna me rezultatet e hetimit më datë 19.06.2019, ka depozituar dhe aktin “Kërkesë për gjykim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”, ku në cilësinë e prokurores së çështjes, ka kërkuar gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të të pandehurit S. N., i akuzuar për veprat penale të vrasjes me dashje, mbetur në fazën e tentativës, në dëm të shtetasit A. M. dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar respektivisht nga nenet 76, 22 e 278/2 të Kodit Penal.

44. Nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit A. A., drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përmendur këtë rrethanë, ndërkohë që është shprehur se: *në rastin konkret, duke mbajtur parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit, me rëndësinë e faktit, mekanizmin e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e veprës penale, sanksionin që parashikohet për këtë veprë penale, si dhe duke pasur parasysh mekanizmin e ngjarjes nga i cili rezulton se personi nën hetim, A. A., ka qenë ai që e ka filluar këtë ngjarje fillimisht i vetëm dhe më pas edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, ekziston rreziku jo vetëm i ikjes, por edhe rreziku se ai mund të kryejë një krim më të rëndë se ai për të cilin po procedohet [...].* Në arsyetimin e bërë në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat shprehet se: *[...] gjykata pranon arsyetimin e prokurorisë që i arrestuari duhet të vazhdojë të qëndrojë të hetohet në gjendje arresti për shkakun se rrezikon që: a) të vë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, b) i pandehuri rrezikon të largohet, c) për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. [...] vihet në rrezik marrja e dëshmisë së personave që kanë dijeni për ngjarjen, kjo për shkak të ekzistencës së mundësisë së intimidimit apo formave të ndryshme të presionit. I arrestuari A. A., është një person që qëndron jashtë shtetit dhe për këtë shkak rrezikon që ai mund të largohet duke iu fshehur hetimeve dhe potencialisht daljes përpara drejtësisë. [...] ekziston në të njëjtën kohë rreziku imediat që ai të mendojë ndonjë hakmarrje të mundshme, ndonëse ka pretenduar që nuk i njeh personat që e kanë plagosur.* Në vendimin e gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, citohet: *Prokurorja Alketa Nushi kërkoi – të pranohet kërkesa e të arrestuarit, për shkak të zbutjes së nevojave të sigurimit personal. [...] në lidhje me këtë kërkesë (për zëvendësim është shprehur edhe qëndrimi i përfaqësuesit të organit akuzues, prokurorë Alketa Nushi, e cila deklaroi që kërkesa për zëvendësim të masës së sigurimit personal dhënë në ngarkim të A. A. duhet të pranohet. Kjo për faktin se përveç të tjerave, ka një deklaratë pajtimi të lëshuar nga shtetasi A. S. gjë që e zbut në mënyrë të ndjeshme nevojat për sigurimin personal të kërkuarit A. A.*
45. Sipas pretendimit të subjektit në ankim, duke qenë se është arritur marrëveshje pajtimi midis shtetasit A. S. dhe A. A., duke pasur parasysh rrezikshmërinë jo të lartë shoqërore të veprës penale (neni 300/1 i K.Penal parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet), si dhe faktin se nuk kishte më rrezik për agravimin e konfliktit, është parë e arsyeshme të pranohet kërkesa për zëvendësim mase sigurimi. Kërkesë kjo e gjetur në përputhje me ligjin dhe e pranuar nga gjykata me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2017.
46. Në funksion të analizimit të këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se rrethanat që janë vlerësuar nga prokurorja e çështjes (subjekti i rivlerësimit) kur është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj A. A., janë të njëjta me ato për të cilat prokurorja ka rënë dakord që të pranohet zëvendësimi i masës së sigurimit, vetëm 9 ditë më vonë. Ndryshimi i vetëm në këtë afat prej 9 ditësh ka qenë një deklaratë noteriale e datës 14.09.2017, mes A. S. dhe A. A., e cila gjendet në arsyetimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për zëvendësimin e masës së sigurimit, në të cilin arsyetohet se: *palët e përfshira në konflikt, më datë 14.09.2017, kanë bërë një deklaratë noteriale sipas së cilës del që janë normalizuar marrëdhëniet mes dy familjeve të përfshira në konflikt. Po në vijim të këtij vendimi, thuhet se A. S. dhe A. A. deklarojnë që ngjarja e ndodhur nuk ka qenë e qëllimshme, A. (A.) ka qenë në gjendje të dehur dhe nuk ka qenë i përgjegjshëm për momentin dhe veprimet e tij kanë qenë të pakontrolluara, gjithçka ka qenë e rastësishme dhe jo e qëllimshme, duke deklaruar më tej që nuk do të kenë probleme në të ardhmen dhe marrëdhëniet e tyre familjare do të jenë siç kanë qenë para se të ndodhte ngjarja.*

47. Trupi gjykues vlerëson se kjo marrëveshje (deklaratë noteriale) nuk i zhbën kushtet dhe kriteret për të cilat ishte vendosur masa e sigurimit, të pranuar edhe nga gjykata në vendimin e saj, të ngritura nga prokurorja në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, arsyetuar dhe në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Së pari, siç rezulton nga aktet procedurale të këtij procedimi penal, A. A. konfliktin nuk e ka pasur me A. S. apo me djemtë e tij, por me shtetasin E. P. dhe marrëveshja e arritur nuk e shuan këtë konflikt, dhe as rrezikun e ndonjë hakmarrjeje të mundshme. Raporti mes personave të përfshirë në konflikt nuk është një kriter mbi të cilin përcaktohen nevojat e sigurimit, aq më shumë në lidhje me hetimin e veprave penale, si ato për të cilat procedohen të dyshuarit në rastin konkret. Së dyti, në kuadër të veprimeve hetimore të mëtejshme, rezulton se pas marrjes së vendimit “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” më datë 14.11.2017, Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2017, informon se nuk është bërë i mundur njoftimi i shtetasit A. A. (A. D.) pasi, sipas deklarimeve të nënës së tij, ai ndodhej jashtë shtetit për mjekim. Në vijim, nga aktet e administruara në dosjen penale, rezulton se më datë 07.08.2018, nga prokurori i çështjes A. M. është nxjerrë urdhër “Për kërkimin e të pandehurit” A. A. *alias* A. D., dhe më datë 03.09.2018, vendimi “Mbi mosgjatjen e të pandehurit”. Pra, pas zëvendësimit të masës së sigurimit nga “Arrest në burg” me “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, shtetasi A. A. rezulton të jetë larguar jashtë vendit, duke iu fshehur hetimeve.
48. Trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit në ankim se masa e sigurimit ndaj A. A. ka rezultuar proporcionale pasi në vazhdimësi nuk ka pasur konflikt midis palëve, nuk është vënë në rrezik marrja e ndonjë prove, pasi të gjitha këto nuk mund të ndodhnin në kushtet kur A. A. ishte larguar jashtë vendit, dhe pikërisht rreziku i ikjes që është konsideruar si një nga shkaqet kryesore, të bërë prezent në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ku ndër të tjera arsyeton: *I arrestuari A.A., është një person që qëndron jashtë shtetit dhe për këtë shkak rrezikon që ai mund të largohet duke iu fshehur hetimeve dhe potencialisht daljes përpara drejtësisë*, rezulton të jetë provuar se ka ndodhur.
49. Nisur nga fakti që nuk konstatohen ndryshime konkrete dhe të rëndësishme në periudhën prej 9 ditëve, që do të legjitimonin zëvendësimin e masës së sigurimit personal dhe që mund të argumentonin ekzistencën e kushteve për zbutjen e masës së sigurisë së vendosur tashmë nga gjykata, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi profesionale në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve lidhur me përcaktimin e masës së sigurimit personal apo ndryshimin e saj. Ndryshimi i pozicionit të subjektit të rivlerësimit në raport me masat e sigurimit, nuk mbështetet as në situatën faktike që justifikon nevojën për ndryshimin e masës dhe as në dispozita ligjore që e mundësojnë atë, duke evidentuar minimalisht dobësi/mangësi në aftësitë profesionale të subjektit, duke pasur në konsideratë edhe informacionet që kanë ardhur nga agjencitë ligjzbatuese.
50. Me anë të vendimeve të marra, pas kryerjes së veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, më datë 08.12.2017, vendosi:
- 50.1. Pushimin e procedimit penal në ngarkim të K. S. për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Sipas arsyetimit të prokurores, vendimi është bazuar në faktin se deklaratimet e A. S. *jo vetëm nuk kanë qenë konsekuente, por dhe në kundërshtim me deklaratimet e gjithë personave të tjerë të cilët janë përfshirë në këtë konflikt.*
- 50.2. T’i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat (gjyqtarit të seancës paraprake) me

kërkesën për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit A. *alias* A. K. dhe shtetasit K. S., për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.

**503.** Nxjerrjen e urdhrin penal nr. {\*\*\*}, datë 08.12.2017, në të cilin urdhërohet caktimi i dënimit me gjobë në masën 50.000 lekë për shtetasit D. S., për veprën penale të “Prishjes së qetësisë publike”, parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal; K. S., E. P. dhe E. P. për veprën penale të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal; S. K., i akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes së municionit luftarak, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, pas kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat (Alketa Nushi), ka vendosur pranimin e kërkesës për miratimin e urdhrin penal nr. {\*\*\*}, datë 08.12.2017.

**504.** Të bëjë kërkesë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve:

- i) A. S., i akuzuar për veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes së municionit luftarak, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, si dhe “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal;
- ii) A. A. *alias* A. D., i akuzuar për veprat penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, dhe “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

**51.** Nga analizimi i akteve të sipërcituara, trupi gjykues konstaton se urdhri i prokurores së çështjes Alketa Nushi, më datë 08.09.2017, për regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit A. S., referon te kryerja e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe të “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, ndërsa në kërkesën e subjektit të rivlerësimit për dërgimin për gjykim të këtij procedimi penal, në ngarkim të të pandehurit A. S., prokurorja cilëson veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes së municionit luftarak, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, si dhe “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

**52.** Pas paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, më datë 09.01.2018, emërohet drejtuese prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës e, për rrjedhojë, përfaqësimi i prokurorisë në seancat gjyqësore u krye nga prokurori A. M., i shortuar për të ndjekur këtë procedim penal. Prokurori në seancën paraprake i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat kthimin e akteve për plotësimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2018, vendosi: *kthimin e akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve brenda një afati 2 (dy mujor).*

Në këtë vendim, gjykata ka çmuar se cilësimi juridik i faktit penal në lidhje me të pandehurin A. S. është i gabuar, *cilësimi i drejtë për të pandehurin A. S. do të ishte ai i parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, pasi të pandehurit në banesë nuk i është gjetur municion luftarak, por armë shpërthyesë, lëndë plasëse në banesë. Detonatori dhe fitili zjarrpërcjellës nënkupton mbajtjen e një arme shpërthyesë në banesë dhe jo municion luftarak, siç ka cilësuar prokuroria.*

Ky vendim u vlerësua i drejtë nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke vendosur lënien në fuqi të tij, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.05.2018.

53. Pas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, prokurori i çështjes A. M., në përfundim të hetimeve të kryera të përcaktuara nga ky vendim, ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. {\*\*\*} të vitit 2017, me të pandehur:

53.1. A. S., i akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal dhe të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, kryer në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

53.2. A. A. (A. D.), i akuzuar për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

53.3. K. S., i akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes së armëve luftarake në mjedise publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

53.4. A. (A.) K., akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe municionit”, kryer në formën e mbajtjes së armëve luftarake në mjedise publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 274 e 25 të Kodit Penal.

54. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të përcjellë nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve të dhëna mbi rezultatet e hetimit (nxjerrë nga sistemi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat), është vendosur:

*Dërgimin e çështjes penale për gjyq për të pandehurin A. S., [...] si i dyshuar për veprat penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, kryer në formën e mbajtjes”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë”, parashikuar nga neni 278/4 të Kodit Penal, pasi ka kërkuar gjykim të shkurtuar. [...]*

*Dërgimin e çështjes penale për gjyq për të pandehurin A. A. (A. D.) [...] si i dyshuar për veprën penale “Prishjes së qetësisë publike” parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal. Pushimin e akuzës për të pandehurin A. A. (A. D.) për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit” parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal. [...]*

*Pushimin e akuzës për të pandehurin A. (A.) K. për veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në formën e mbajtjes së armëve luftarake në mjedise publike”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe të “Prishjes së qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 274 e 25 i Kodit Penal.*

*Pushimin e akuzës për të pandehurin K. S. për veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë”, parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal dhe të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.*

55. Me shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ [24.06.2019], subjekti i rivlerësimit depoziton shkresën nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2019, “Kthim përgjigje” të Gjykatës së

Apelit Tiranë, nëpërmjet së cilës informon se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2019, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

56. Referuar akteve të dosjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017 dhe gjithë vendimeve gjyqësore të marra për këtë procedim penal, trupi gjykues konstaton se sa u takon akuzave të ngritura ndaj të pandehurit A. S., së pari subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar, pa argumentuar arsyet, cilësimin e faktit penal në ngarkim të shtetasit A. S. nga neni 278, paragrafi 4 i Kodit Penal, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në formën e mbajtjes në banesë të lëndës shpërthyesë, që parashikon: *mbajtja e armëve shpërthyesë ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet, duke e cilësuar në kërkesën për dërgimin për gjykim, sipas paragrafit 2 të po këtij neni, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në formën e mbajtjes së municionit luftarak, sipas së cilit: mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.* Ky cilësim i veprës penale në ngarkim të të pandehurit A. S., është gjetur i gabuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, në vendimet nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2018 dhe nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2019, vendime këto të lëna në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.
57. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në kryerjen e veprimeve hetimore të plota që do të çonin në zbardhjen e rrethanave të çështjes dhe të konfliktit në këtë procedim penal ku, sipas akteve procedurale, ka rezultuar të jetë përdorur armë zjarri, nga ku ka mbetur i plagosur shtetasi A. A. (alias A. D.), dhe ku në vendngjarje janë gjetur 7 gëzhoja. Veprimet hetimore të munguara, të cilat kanë çuar gjykatën në *kthimin e akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve brenda një afati 2 (dy mujor), janë përmendur dhe në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, e cila arsyeton se prokuroria duhet të analizojë dhe të hetojë në lidhje me deklaratimet e ndryshme e që kundërshtojnë njëra-tjetrën, për sa i përket faktit se kush ishte personi që A. S. i ka parë armën luftarake tip pistoletë me të cilën është qëlluar i pandehuri tjetër A. A., [...] duke marrë e ripyetur edhe persona të tjera që tregojnë rrethana të hetimit si K. S., D. S., E. P., A. K., E. P., si dhe S. K. Kur ka kundërrhënie, prokuroria gjatë kryerjes së hetimeve plotësuese duhet të disponojë me ballafaqimet duke respektuar dispozitat e nenit 169 e 170 të Kodit të Procedurës Penale. [...] gjatë vazhdimin të hetimeve organi i prokurorisë duhet të kryejë të gjitha veprimet hetimore që kanë të bëjnë me gjetjen e autorit të mbajtjes pa leje të armës luftarake, me të cilën është plagosur A. A. [...] të ripyeten të gjithë personat prezent në vend ngjarje rreth këtij momenti të rëndësishëm duke kryer edhe ballafaqimet e mundshme, këqyrjen e personave. Të hetohet rreth faktit nëse përveç personave që janë pyetur më parë si persona të përfshirë në këtë konflikt a ka patur persona të tjerë qytetarë, policë, si dhe në lokalin ku është zhvilluar konflikti dhe lokalet e tjerë përreth a ka kamera sigurie që mund të kenë filmuar ngjarjen. Në hetimet paraprake nuk është pyetur dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim personi nën hetim A. (A.) K. dhe nuk ka asnjë akt që të tregojë kërkimet dhe mosgjetjen e tij [...].*
58. Subjekti pretendon se asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit nuk ka qasjen e duhur në njohjen e ligjit material penal dhe atij procedural penal. Ky fakt del qartë në këto momente. Çdo person i cili në një procedim penal merr atributet e personit nën hetim apo të pandehur, nuk mund të merret në përgjegjësi penale për deklarimin e rremë përpara prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore dhe as për dëshmi të rremë përpara gjykatës kur ata ndryshojnë deklaratimet e tyre si gjatë fazës së hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë gjykimit.



Këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi vlerësimi i Komisionit është mbështetur pikërisht në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, e cila arsyeton: *të hetohet dhe të mbahet qëndrim ligjor lidhur me faktin nëse të pandehurit A. S. dhe A. A. apo persona të tjera gjatë deklarimeve të mëparshme të tyre, si dhe gjatë vazhdimit të hetimeve konsumojnë vepra të tjera penale si ato të “Deklarimeve të rreme përpara prokurorit”, parashikuar nga neni 305/a i Kodit Penal, apo atë të “deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, sipas nenit 305/b të K.Penal, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.*

59. Pretendimin e subjektit në ankim, se çështja penale në ngarkim të këtyre shtetasve është ende në procedurë gjykimi dhe referuar nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, ashtu dhe ligjit nr. 84/2016, nuk duhet përfshirë në vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi ky parashikim kushtetues lidhet me çështjet që janë duke u shqyrtuar nga subjekti (prokurori) gjatë procesit të rivlerësimit, për të cilat prokurori nuk ka konkluduar me vendim (pushimin e akuzës apo çështjes, kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq etj.), sipas parashikimit të nenit 327, pika 6, e nenet vijuese të Kodit të Procedurave Penale.
60. Ligji nr. 84/2016, në nenin 43, pika 1 e tij parashikon se *procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm*. Një nga indikatorët e vlerësimit të prokurorit, sipas parashikimit në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është aspekti i njohurive ligjore, i cili vlerësohet *duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendimi, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën*.
61. Në përfundim, për sa më sipër, në dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve A. S. dhe A. A. (alias A. D.), nga trupi gjykues i Kolegjit u evidentuan mangësi profesionale për sa i përket hetimit të rrethanave të çështjes dhe përcaktimin e personave përgjegjës dhe rolin e gjithsecilit, mangësi në drejtim të kualifikimit të veprës penale, mosvlerësim i duhur i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit dhe mangësi në drejtim të veprimtarisë së mëtejshme hetimore për zbardhjen e plotë të çështjes duke afektuar kriterin e aftësisë profesionale të subjektit, parashikuar nga neni 73, pika 2<sup>11</sup> e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, nuk arritën të ishin bindëse.
- *Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasve A. Gj. dhe E. D.*
62. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, sipas Komisionit: *edhe pse për një periudhë të caktuar subjekti nuk ka pasur këtë dosje në hetim, ajo ka kryer pothuajse të gjitha veprimet hetimore – pjesë të të cilave janë konsideruar nga gjykata si jo të rregullta. Gjithashtu, mangësitë e konstatuara për dy herë rresht nga gjykata, lidhur me hetimet e paplota, dhe me mospërmbushjen e urdhrave të dhëna nga gjykata, sigurisht që pasqyrojnë*

---

<sup>11</sup> Neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, parashikon: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.

*edhe mangësi profesionale të personave për veprimet apo mosveprimet e tyre të përsëritura – me përjashtim të rastit hipotetik, nëse dhe kur mund të provohej se ato veprime/mosveprime/pasoja kanë qenë të vetëdijshme, të qëllimshme apo për neglizhencë të tolerueshme. Për rrjedhojë, në rastin konkret, për sa kohë veprimet apo mosveprimet e subjektit kanë rezultuar jo në përputhje me dispozitat procedurale ligjore, apo me urdhrin e gjykatës, Komisioni çmon se ato përbëjnë, së paku, mangësi profesionale.*

63. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, duke ngritur disa shkaqe ankimore që konsistojnë kryesisht në: i) Kthimi i akteve për plotësim hetimesh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2018, është aspekt procedural dhe nuk prezumon mangësi profesionale, mungesë paanësie apo qëndrim favorizues, për sa kohë nuk është bërë me keqbesim. ii) Sa u përket konstatimeve të gjykatës për aktin “Për përfundim hetimesh, datë 20.01.2018”, ligjshmërinë e veprimeve të oficerit të policisë gjyqësore duhet ta vlerësonte prokurori që e ka zëvendësuar më pas në hetimin e këtij procedimi, pasi subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 09.01.2018, u caktua drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës.
64. Nga analizimi i akteve të këtij procedimi penal, të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit deri në momentin e emërimit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, trupi gjykues nuk konstaton veprime apo qëndrime të subjektit të cilat mund të favorizonin të pandehurit A. Gj. apo E. D., pasi subjekti i rivlerësimit i kërkon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, caktimin masë sigurimi “arrest në burg” ndaj shtetasit E. D., po kështu më datë 29.12.2017, subjekti i rivlerësimit kërkon para gjykatës rrëzimin e kërkesës së të pandehurit A. Gj., për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”, “garanci pasurore” apo “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
65. Lidhur me konkluzionet e Komisionit në vendim, trupi gjykues vlerëson se hetimet e paplota apo mosveprimet jo në përputhje me urdhrin e gjykatës nuk mund t’i atribuohen të gjitha subjektit të rivlerësimit, kjo për arsye se, siç rezulton nga aktet e fashikullit, subjekti i rivlerësimit, sipas urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, prej datës 09.01.2018, caktohet drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat vërtet nëpërmjet dy vendimeve të saj, përkatësisht vendimit nr. {\*\*\*}, të datës 15.03.2018, dhe vendimit të datës 24.04.2018, ka vendosur *kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për plotësim të hetimeve pasi ato konsiderohen të paplota*, por vetëm në vendimin e parë të datës 15.03.2018, konstatohen disa parregullsi të veprimeve hetimore të kryera nga subjekti, që konsistojnë kryesisht në deklaratimet e marra nga shtetasit S. D. dhe Sh. D., për të cilat nuk janë respektuar kriteret e vendosura në nenin 158 të Kodit të Procedurës Penale, që ka të bëjë me njoftimin për të drejtën e përjashtimit nga detyrimi për të dëshmuar. Sipas gjykatës, personat e pyetur si deklarues janë thirrur dhe pyetur në mënyrë shumë të përciptë, duke sjellë si pasojë mosmarrjen e një informacioni të plotë e të thelluar rreth fakteve objekt hetimi.
66. Në kushtet kur vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për plotësim të hetimeve, datojnë pas emërimit të subjektit të rivlerësimit në një prokurori tjetër dhe në kushtet kur veprimet e paplota hetimore nuk mund t’i atribuohen subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, nuk konkludoi në konstatimin e mangësive profesionale të subjektit, sa i përket këtij procedimi penal.

➤ *Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit F. N.*

67. Komisioni, për këtë procedim penal, ka vlerësuar *se: (a) kualifikimi i veprës penale i bërë në mënyrë jo korrekte, nga ana e subjekti, lidhur me plagosjet në fjalë – pasi njëra prej të cilave*

*ka shkaktuar pasoja me paaftësi mbi 9 ditë; (b) zbutja e masës së sigurisë me pëlqimin e subjektit, më 15.2.2013, nuk është bazuar në ndryshime konkrete të rrethanave; (c) moskryerja e hetimeve të plota dhe të gjithanshme; (ç) moskonkludimin e hetimeve edhe me akuzën plagosjes me cilësimin e duhur juridik, pasi personi nën hetim, ishte identifikuar nga vetë subjekti si autori i veprës penale, por ajo është kualifikuar në mënyrë jo të saktë dhe në mospërputhje me faktet dhe rrethanat, përbëjnë një sërë mangësish profesionale të subjektit, që kanë ndikuar në veprimet hetimore në fjalë – siç janë specifikuar edhe nga drejtuesi i prokurorisë në vendimin e tij të shfuqizimit të pushimit të hetimit, që e kanë bërë të domosdoshme zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit me një tjetër prokuror, për të ndjekur këtë dosje, dhe konfirmuar edhe nga Prokurori i Përgjithshëm.*

**68.** Nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit F. N., trupi gjykues konstaton si vijon.

**68.1** Më datë 14.11.2012, në fshatin {\*\*\*}, të rrethit Mat, ka pasur një konflikt në lokalitetin e shtetasit L. N., mes shtetasit F. N. dhe shtetasve Y. N., G. N. dhe S. N. F. N., pasi është goditur nga këta shtetas, ka shkuar në shtëpi, ku ka vënë në dijeni për këtë fakt vëllain e tij E. N. dhe të dy janë nisur drejt lokalitetit të L. N. për të sqaruar konfliktin. Rrugës kanë takuar shtetasin Y. N., dhe janë goditur e përleshur. Gjatë këtij konflikti fizik, është përdorur dhe armë zjarri e nga të shtënat kanë mbetur të plagosur shtetasit Y. N. dhe L. N.

**68.2** Nga analizimi i aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2012, të administruar në dosjen penale, dëmtimet e konstatuara në trupin e shtetasit Y. N. hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat sjellin për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë. Ndërsa dëmtimet e konstatuara ndaj shtetasit L. N., sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 16.11.2012, hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të cilat sjellin për pasojë humbjen e aftësisë për punë deri në 9 (nëntë) ditë.

**68.3** Me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 16.11.2012, prokurorja e çështjes Alketa Nushi urdhëron regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012 për veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë, 25 dhe 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, në emër të personave që u atribuohet vepra penale, E. N. dhe F. N.

**68.4** Me vendimet nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, datë 19.11.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat vendosi pranimin e kërkesave të prokurores Alketa Nushi për vleftësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë, të marrë respektivisht ndaj shtetasit E. N. dhe F. N., të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, dhe caktimin si masë sigurimi personal “Arrest në burg” me afat 30-ditor.

**68.5** Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, pyetjen në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, L. N., A. N., B. N., Sh. N. dhe Y. N., dëshmitarë okularë të kësaj ngjarjeje, me urdhrin “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, datë 19.12.2012, vendoset regjistrimi i personit që i atribuohet vepra penale, shtetasi F. N., i dyshuar për veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë e 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

**68.6** Me urdhrin e datës 20.12.2012, “Për ndalimin e të dyshuarit për një krim”, subjekti i rivlerësimit urdhëroi ndalimin e shtetasit F. N. si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale

të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë e 22 të Kodit Penal.

**68.7** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2012, vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat (Alketa Nushi) dhe vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të vendosur ndaj shtetasit F. N., i dyshuar se ka kryer veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë dhe 22 të Kodit Penal, si dhe caktimin si masë sigurimi personal për shtetasin F. N., “Arrest në burg”, sipas nenit 238 të K.Pr.Penale.

**68.8** Më 12.02.2013, prokurorja e çështjes vendos pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim F. N., për dëmtimet e konstatuara te shtetasit R. (Y.) N. dhe L. N. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, citohet: *nga tërësia e veprimeve hetimore, konkludohet se shtetasi F. N. është autor i veprës penale të plagosjes së lehtë nga pakujdesia të shtetasve L. N. dhe R. (Y.) N.*

*Për sa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 92 i Kodit Penal<sup>12</sup>, prokurori është përjashtuar me ligj nga e drejta për ushtrimin e ndjekjes penale. Për këtë kategori veprash penale, i dëmtuari akuzues kërkon ushtrimin e ndjekjes penale drejtpërsëdrejti në gjykatë konform përcaktimeve të neneve 59 dhe 60 të Kodit të Procedurës Penale<sup>13</sup>.*

**68.9** Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat vendosi pranimin e kërkesës së të arrestuarit F. N. dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, të vendosur me vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2012, duke caktuar si masë sigurimi personal atë të “arrestit në shtëpi”. Prokurorja Alketa Nushi është shprehur për pranimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi me vendim nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

**68.10** Me vendimin e datës 19.02.2013, “Mbi dërgimin e çështjes për gjykim”, prokurorja e çështjes Alketa Nushi vendosi dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të të pandehurit F. N., i akuzuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

**68.11** Drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin e datës 18.03.2013, vendosi: *1. Për shfuqizimin e vendimit, datë 12.02.2013, për pushimin e hetimit në ngarkim të personit nën hetim F. N. 2. Shfuqizimin e vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës datë 12.02.2013, 3. Shfuqizimin e vendimit datë 19.02.2013 për dërgimin e çështjes për gjykim 4. Shfuqizimin e procesverbalit datë 13.02.2013 për njohjen e të pandehurit me aktet e çështjes, në procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2012, si dhe akteve të lidhur me këtë akt. 5. Zëvendësimin e prokurores Alketa Nushi dhe oficerit të policisë gjyqësore F. D. me prokuror L. F. dhe oficerin e policisë gjyqësore I. H., për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve të këtij procedimi [...].*

---

<sup>12</sup> Neni 92 i Kodit Penal, “Plagosja e lehtë nga pakujdesia”: “Plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

<sup>13</sup> Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, “Viktima akuzuese”: “1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 43 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërbimin e dëmit. [...]”.

Neni 60 i Kodit të Procedurës Penale, “Kërkesa e viktimës akuzuese”: “1. Kërkesa për gjykim e viktimës akuzuese depozitohet në sekretarinë e gjykatës. Ajo është e pavlefshme në qoftë se nuk përmban: [...]. 2. Kërkesa duhet të njoftohet personit që akuzohet dhe prokurorit”.

Në arsyetimin e këtij vendimi, drejtuesi i prokurorisë, pa hyrë në argumentimin e pjesës konstatuese të vendimit të pushimit të hetimeve në ngarkim të personit nën hetim F. N. dhe të akteve të tjera, konstaton se:

*[...] Rezulton se nga ana e prokurores nuk janë analizuar në tërësi provat e administruara në fashikullin e procedimit penal në fjalë, nuk është argumentuar dhe provuar nëse personi nën hetim F. N. ka kryer veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese, mbetur në tentativë”, për të cilën është regjistruar në ngarkim të tij, apo për veprën penale të plagosjes së lehtë nga pakujdesia.*

- *Veç sa më sipër, hetimi është i mangët jo vetëm proceduralisht, por nuk janë kryer veprimet e domosdoshme që kanë të bëjnë me sqarimin e rrethanave të ngjarjes.*
- *Nuk janë administruar predha e gjetur në trupin e të dëmtuarit Y. N. dhe nuk është kryer ekspertimi balistik i saj.*
- *Nuk është sqaruar mekanizmi i ngjarjes, rrethanat e ndodhjes dhe çfarë konflikti kanë pasur shtetasit F. N. dhe Y. N., nëse kanë pasur konflikt më parë për çfarë e kanë pasur.*
- *Gjatë konfliktit fizik ndërmjet personave të lartpërmendur, nuk është sqaruar fakti se ku ndodhej shtetasi F. N., vendi, distanca ndërmjet personave që ishin në konflikt dhe personit nën hetim F. N.*
- *Në ç’mënyrë dhe rrethana ka qëlluar, në çfarë drejtimi, sa herë ka qëlluar, pasi në vendngjarje janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale një gëzhojë dhe njëfishek kalibër 6.35 mm që përdoren nga pistoleta baretta dhe automatikët [...].*
- *Ndonëse në vendimin e pushimit merren si të vërteta shpjegimet e shtetasit A. N., deklaratimet e shtetasit B. N. të dhëna para policisë gjyqësore dt. 06.12.2012, si dhe deklaratimet e shtetasit Sh. N. të dhëna para policisë gjyqësore, dt. 05.12.2012, nuk analizohen në pjesën arsyetuese të vendimit të pushimit të hetimeve.*
- *Nuk është bërë ballafaqimi mes tyre dhe personi nën hetim F. N., sipas kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 169 e vijues të K.Pr.Penale.*

*Në këto rrethana, për shkak të mangësive të theksuara procedurale, vendimi i pushimit të hetimeve në ngarkim të personit nën hetim F. N., vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës dt. 12.02.2013, vendimi i dërgimit të çështjes për gjykim, kërkesa për gjykim, procesverbal për njohje me aktet, duhen shfuqizuar për të bërë plotësimin e hetimit për faktet e cilësuar në pjesën konstatuese të këtij vendimi.*

**68.12** Prokurorja Alketa Nushi, duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm të drejtuesit të prokurorisë, më datë 08.05.2013, ka paraqitur ankim te Prokurori i Përgjithshëm, duke kërkuar prishjen e vendimit të shfuqizimit të akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012, dhe lënien në fuqi të mënyrës së përfundimit të këtij procedimi nga prokurori i çështjes.

**68.13** Prokurori i Përgjithshëm, më datë 11.06.2013, me vendimin “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë”, arsyeton se pas marrjes në shqyrtim të akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe ankimin, datë 08.05.2013, të prokurores Alketa Nushi kundër vendimit të datës 18.03.2013 të drejtuesit të prokurorisë A. M., “Për shfuqizimin e akteve”, gjen në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal dhe ligjit material penal, vendimin e drejtuesit të prokurorisë, ndërsa ankimin e prokurorit të çështjes e gjen të pabazuar në rrethanat e faktit dhe në ligj, duke vendosur: *mospranimin e ankimit të prokurorit të çështjes Alketa Nushi ndaj vendimit, datë 18.03.2013, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, “Për shfuqizimin e akteve”.*

**68.14** Prokurori i Përgjithshëm, në këtë vendim arsyeton, në mënyrë të përmbledhur, se: i) në gjendjen që ishin aktet e procedimit penal, prokurori i çështjes nuk duhet të merrte vendim për dërgimin e çështjes në gjyq për të pandehurin F. N. dhe pushimin e hetimeve ndaj tij për dëmtimet trupore shkaktuar shtetasve Y. dhe L. N.; ii) vendimi për pushimin e hetimeve është

marrë në shkelje të neneve 328, 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe në kuptim e zbatim të gabuar të këtyre dispozitave lidhur me cilësimin juridik të drejtë të faktit penal; iii) nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për të sqaruar plotësisht rrethanat e faktit, qëllimin, numrin e personave të përfshirë në kryerjen e veprës penale, rolin e secilit etj.; iv) nuk është sqaruar plotësisht mekanizmi i ngjarjes, shkaku i konfliktit, pozicioni i personave në konflikt në momentin e përleshjes, rrethanat në të cilat ka qëlluar F. N. me armë zjarri, drejtimi dhe distanca e qitjes; pyetja e përciptë e personave që kanë qenë në vendngjarje që nuk ka shërbyer për sqarimin e plotë të rrethana të ngjarjes; v) prokurorja e çështjes u ka dhënë vlerë të paracaktuar deklarimeve të të pandehurit F. N., si dhe ka anashkaluar provat e tjera të administruara gjatë hetimit. Megjithëse i pranon si të vërteta shpjegimet e shtetasve A. N., B. N. dhe Sh. N., të cilët shpjegojnë ngjarjen dhe veprimet e të pandehurit, nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk janë analizuar në raport me provat e tjera. Madje, në ankim prokurorja e çështjes pranon vlerën e paracaktuar të deklarimeve apo qëndrimit të të pandehurit kur shprehet se qëndrimi mohues i të pandehurit është bërë pengesë për kualifikimin e duhur ligjor të veprës penale etj.

**68.15** Më datë 02.07.2013, prokurori A. M., pasi konstatoi se janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme dhe janë mbledhur provat që vërtetojnë fajësinë e të pandehurit për veprën penale, ka vendosur *dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2012, në ngarkim të të pandehurit F. N., akuzuar për veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 79/ë – 22, dhe 278/2 të Kodit Penal.*

**68.16** Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.04.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, për këtë çështje penale, vendosi: *Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën të “Vrasjes nga pakujdesia”, mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 85 e 22 të Kodit Penal dënimin e tij me dy vite burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkimitë dënimeve, e dënon përfundimisht të pandehurin me dy vite burgim [...].*

Sipas shënimit në vendimin e sipërcituar, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si më poshtë:*

*Deklarimin fajtor të pandehurit F. N. për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.*

*Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. N. për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 89 i K. Penal.*

**69.** Komisioni, pas administrimit të dokumentacionit në lidhje me këtë procedim penal, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për sa vijon.

- [...] duket se kualifikimi i veprës penale, është bërë në mënyrë të tillë që të mundësohej mosvijimi (pushimi i procedimit penal), duke favorizuar personin nën hetim, pasi lindi dyshime mbi një kualifikim jo korrekt, nga subjekti, të veprës penale lidhur me plagosjet – njëra prej të cilave me pasoja mbi 9 ditë paaftësi dhe nuk duket se të dyja plagosjet mund të qenë pasojë vetëm e një pakujdesie të autorit – dhe me zbutjet e masës së sigurisë me pëlqimin e saj, më datë 15.02.2013, si dhe konstatohen mangësi në formulimin e akuzave, duke anashkaluar faktin se nga rrethanat del se ka pasur edhe prishje të qetësisë publike nga të gjithë personat e hetuar (disa prej të cilëve ishin të dehur), por askujt nuk i është bërë një akuzë e tillë.

- Në këtë çështje, janë evidentuar një sërë mangësish profesionale të subjektit, që kanë ndikuar

*në veprimet hetimore në fjalë, siç janë specifikuar edhe nga drejtuesi i Prokurorisë në vendimin e tij të shfuqizimit të pushimit të hetimit, që e kanë bërë të domosdoshëm zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit me një tjetër prokuror, për të ndjekur këtë dosje.*

70. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit, mban të njëjtën qëndrim, si më pas në ankimin e paraqitur në Kolegj, se vendimmarrja e saj është konsideruar e drejtë, pasi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pikërisht deklarimin fajtor të të pandehurit F. N., për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin me 2 vjet e 6 muaj burgim. Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. N., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.
71. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të dosjes penale, së pari konstaton se, në vendimin “Për pushimin e hetimeve”, datë 12.02.2013, të subjektit të rivlerësimit në ngarkim të personit nën hetim F. N., për dëmtimet e konstatuara te shtetasit R. (Y.) N. dhe L. N., subjekti e ka cilësuar veprën penale “Plagosje e lehtë nga pakujdesia”, të parashikuar në nenin 92 të Kodit Penal: “Plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”. Gjykata e Apelit Tiranë, ndryshe nga sa pretendon subjekti, në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2014, ka arsyetuar se dëmtimet e shkaktuara hyjnë në kategorinë plagosjeve të lehta, të parashikuara nga neni 89 i Kodit Penal, “Plagosja e lehtë me dashje”: “Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”. Gjykata e Apelit Tiranë ka pushuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, meqenëse vepra penale ka ndodhur më 14.11.2012, për shkak të ligjit “Mbi dhënien e amnistisë”, si dhe faktit se të dëmtuarit nuk kanë bërë ankim, bazuar kjo në nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale. Sa më sipër, rezulton se formulimi i akuzës nga subjekti i rivlerësimit, “Plagosje e lehtë nga pakujdesia”, ndërkohë që nga veprimet e kryera, nga i pandehuri janë plagosur dy persona, njëri prej të cilëve me dëmtime që sjellin për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë, nuk ka qenë i bazuar. Në këtë kuptim, pakujdesia si formë faji nuk duket logjike të lidhet me përdorimin e armës, të paktën dy herë, gjetjen në vendin e ngjarjes të një gëzhoje dhe një fisheku, për këtë arsye vërehet mangësi në arsyetimin e vendimit të pushimit të hetimeve në ngarkim të personit nën hetim F. N., për dëmtimet e konstatuara te shtetasit R. (Y.) N. dhe L. N. dhe që vijnë edhe si pasojë e logjikës së gabuar në përcaktimin e elementeve të veprës penale.
72. Nga analizimi i akteve të dosjes penale, rezulton se gjatë periudhës kohore nga regjistrimi i personit që i atribuohet vepra penale, shtetasit F. N., i dyshuar për veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/ë, e 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, me urdhrin e datës 19.12.2012 dhe deri në vendimin e datës 12.02.2013 “Për pushimin e hetimeve”, në ngarkim të personit nën hetim F. N., për dëmtimet e konstatuara te shtetasit R. (Y.) N. dhe L. N., për të cilat ka konkluduar se i përkasin veprës penale “Plagosje e lehtë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 92 i Kodit Penal, nga subjekti i rivlerësimit janë ndërmarrë vetëm këto veprime hetimore: (i) marrja e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet F. N. dhe më datë 11.02.2013, (ii) marrja e të dhënave nga personi që ka dijeni për rrethanat e hetimit, z. A. N.; (iii) marrja e të dhënave nga personi që ka dijeni për rrethanat e hetimit, z. R. N. (i biri i të dyshuarit). Pra, në këtë periudhë kohore nuk ka pasur asnjë të dhënë thelbësore të dalë nga një veprimtari hetimore e plotë që të çonte prokuroren e çështjes në cilësimin ndryshe të veprës penale. Me konsideratë konstatimet në vendimin e datës 18.03.2013 të Drejtuesit të Prokurorisë, ashtu dhe vendimin e datës 11.06.2013 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit të

prokurorisë”, përmendur në paragrafët 68.11 dhe 68.14 të këtij vendimi, konstatohen një sërë mangësish profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në vlerësim të trupit gjykues, afektojnë treguesin e parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, që lidhet me zhvillimin e logjikshëm të hetimit.

73. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2018, ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme se në regjistrin e njoftimit të veprave penale rezulton se ndaj shtetasës Alketa Nushi janë kryer verifikime në kuadrin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për të cilin është vendosur mosfillim i procedimit, si dhe procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, për të cilin është vendosur pushimi i procedimit.

Sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2014, rezulton se mbi bazën e materialit të referuar nga Prokuroria e Përgjithshme, adresuar nga shtetasi L. B., më datë 26.03.2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, që lidhet me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2012 në ngarkim të shtetasit F. N. Më datë 24.06.2014 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është shpallur moskompetenca lëndore për hetimet paraprake të procedimit penal dhe dërgimi i akteve Prokurorisë për Krime të Rënda, Tiranë, si prokuroria kompetente.

Me vendimin e datës 30.07.2015, prokurori i çështjes pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, Tiranë, vendosi *pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*

74. Në përfundim, mbi këtë procedim penal, dhe pse nuk janë të provuara fakte mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2012, përsëri janë konstatuar mangësi profesionale në kryerjen e veprimeve hetimore, si përcaktuar në vendimin e datës 18.03.2013 të drejtuesit të prokurorisë “Për shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 12.02.2013, vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës datë 12.02.2013, vendimit për dërgimin e çështjes për gjykim, datë 19.02.2013 dhe të procesverbalit për njohjen e të pandehurit me aktet e çështjes, datë 13.02.2013 në procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2012”, ashtu dhe në vendimin e datës 11.06.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë”, të cilat, në vlerësim të trupit gjykues, nxjerrin në pah mangësi dhe hetim të dobët të kryer nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka bërë të pamundur zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes dhe rolit dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të, situatë faktike e cila vë në dyshim serioz thelbin e vendimmarrjes së prokurores për akuzat e personave të përfshirë në ngjarjen kriminale duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2012, nuk arritën të ishin bindëse.

➤ *Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit S. Xh.*

75. Komisioni, për këtë procedim penal, ka vlerësuar se, *në kryerjen e veprimeve hetimore për këtë çështje, janë evidentuar një sërë mangësish profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë ndikuar në veprimtarinë hetimore në fjalë, [...] dhe evidentuar nga drejtuesi i prokurorisë në vendimin e tij të shfuqizimit të vendimit të subjektit – si dhe të konfirmuara edhe nga vlerësimi dhe vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm. Nga këto mangësi hetimore është motivuar*



*ndërhyrja e drejtuesit të institucionit për të bërë të nevojshëm vijimin e hetimit dhe për të urdhëruar hetime shtesë.*

*Lidhur me urdhrin e arrestit, evidentohet fakti që ky veprim hetimor është i domosdoshëm jo vetëm për kapjen e mundshme të personit të kërkuar në territorin shqiptar, por edhe për të vijuar më tej me urdhrin e kerkimit ndërkombëtar – siç është vepruar më pas në të njëjtin rast – nëpërmjet të cilit mundësohet edhe kërkesa për ekstradimin e të larguarit/kërkuarit.*

76. Nga analizimi i akteve të dosjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015, rezulton se Posta Shqiptare Sh.A., filiali Mat, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.12.2014, ka përcjellë pranë Prokurorisë së Rrethit Mat, denoncimin për braktisjen e punës nga ana e agjentit postar S. Xh., i ngarkuar me kryerjen e pagesave të pensioneve të paaftësisë për Komunën {\*\*\*}. Këtij agjenti i ishte dhënë shuma 1.200.100 lekë për të shpërndarë, dhe pasi kishte paguar vetëm 6 përfitues në shumën 78.000 lekë, shtetasi S. Xh. kishte marrë shumën tjetër 1.122.100 lekë, dhe kishte braktisur detyrën pa dhënë asnjë njoftim për vendndodhjen e tij apo të shumës së parave.
77. Më datë 13.01.2015, prokurorja e çështjes Alketa Nushi, me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, urdhëron: *1. Regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2015 për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. 2. Në regjistrimin për njoftimin e veprave penale në kolonën përkatëse të shënohet emri i personit që i atribuohet vepra penale të shtetasit: S. Xh., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” [...].*  
Pas regjistrimit të procedimit penal, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat i drejtohet me kërkesë Prokurorisë së Përgjithshme, me anë të së cilës kërkon certifikatë të gjendjes gjyqësore për shtetasin S. Xh., si dhe me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2015, i drejtohet Komisarariatit të Policisë Mat mbi të dhënat e sistemit TIMS për këtë shtetas, nëse ndodhet në Shqipëri apo jashtë vendit. Komisarati i Policisë Mat, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2015, informon se nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se shtetasi S. Xh. është larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më datë 18.11.2014 dhe prej kësaj date nuk ka hyrje të regjistruar në sistem.
78. Më datë 23.02.2015, prokurorja Alketa Nushi merr vendimin “Mbi mosgjjetjen e të pandehurit”, në të cilin citohet: *[...] Në përfundim të hetimeve të këtij procedimi penal kanë rezultuar të dhëna të mjaftueshme për ngritjen e akuzës në ngarkim të këtij shtetasi dhe sa sipër në datë 19.02.2015 është vendosur për marrjen si të pandehur të shtetasit S. Xh. për veprën penale të parashikuar nga neni 135 të KP. Nga kqyrja e sistemit TIMS rezulton se i pandehuri S. Xh. ka lënë territorin e Republikës së Shqipërisë në datë 18.11.2014, sa sipër, si dhe duke u mbështetur në nenet 141/1 dhe 142/2 të KPP vendosi të deklarojë mosgjjetjen e të pandehurit S. Xh. [...] 2. Të caktojë si mbrojtës për të pandehurit S. Xh., av. S. P. 3. Njoftimi i akteve për të pandehurin të bëhet nëpërmjet av. S. P.*  
Po në të njëjtën datë, prokurorja Alketa Nushi vendos dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit S. Xh., i akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal.
79. Drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin e datës 04.03.2015, vendosi: *1. shfuqizimin e vendimit datë 23.02.2015, për dërgimin e çështjes për gjykim, të procesverbalit datë 23.02.2015 për njohjen e të pandehurit me aktet e çështjes, si dhe akteve të lidhur me këtë akt në procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015. 2. Kryerjen e veprimeve hetimore nën drejtimin e prokurores të ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal Alketa Nushi, e cila do të bëjë dhe ndarjen konkrete të detyrave, këto veprime hetimore të kryhen brenda datës 25.03.2015. 3. Me këtë vendim të njihet prokurore Alketa Nushi dhe opgj I. H. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim tek Prokurori i Përgjithshëm.*

Sipas drejtuesit të prokurorisë në këtë vendim, për hetimin e plotë e të gjithanshëm të këtij procedimi penal, përveç sa ishte kryer deri në atë fazë të hetimeve, ishte e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, si: i) të verifikohej dosja personale e marrjes në punë të të pandehurit S. Xh. dhe administrimi në dosjen e hetimit të urdhrit/vendimit të emërimit të tij në këtë detyrë; ii) të merren deklarime nga 6 persona përfitues të pensionit të paaftësisë, që sipas borderosë rezultojnë të jenë paguar; iii) të thirren e të merren deklarime nga tre-katër persona që janë përfitues, por që pagesën e muajit nëntor të vitit 2014 nuk e kanë marrë, të tregojnë në lidhje me faktin se nga cili person e merrnin pagesën e paaftësisë, sa muaj kishin që nuk e merrnin, në kohën që nuk e morën pagesën e paaftësisë a janë interesuar dhe a kanë pyetur për personin që shpërndante këtë pagesë se ku ndodhej, pse nuk u kishte shpërndarë lekët personave që përfitonin pagesën e paaftësisë etj; iv) të administrohet aktmarrëveshja midis Postës Shqiptare ShA, filiali Mat dhe ISSH për mënyrën e pagesës, si dhe të merren nga të dyja institucionet të dhëna nëse ka diferenca të papaguara i pandehuri gjatë viteve që ka ushtruar detyrën; v) të merret dhe të administrohet në dosjen e hetimit dëshmia e penaltetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit (kërkesë e nenit 332/1, germa “d” e K.Pr.Penale).

Në vendimin e drejtuesit të prokurorisë, ndër të tjera arsyetohet se: i) për hetimin e çështjes është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore I. H., i cili ka kryer veprime hetimore pa qenë i urdhëruar ose deleguar nga prokurori, sipas nenit 30/2 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale; ii) në dosjen e hetimit konstatohet se ka vendim për mosgjjetjen e të pandehurit, në një kohë që nuk ka një urdhër kërkimi për të pandehurin S. Xh.. Në rastin konkret për këtë të pandehur nuk ka asnjë njoftim për t’u paraqitur në organin e prokurorisë apo një urdhër kërkimi për të. Vepra penale e kryer nga i pandehuri S. Xh. për të cilën ka prova paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore, ka si masë dënimi vetëm burgimin deri në 10 vjet. Sipas drejtuesit të Prokurorisë në këtë vendim, duhet të bëhet kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat për caktim mase sigurimi për të pandehurin S. Xh., sipas neneve 244/1, 228/1/2/3 germa “b” dhe 229 të K.Pr.Penale.

80. Duke mos qenë dakord me vendimin e drejtuesit të prokurorisë, më datë 09.03.2015, prokurorja e çështjes Alketa Nushi i drejtohet Prokurorit të Përgjithshëm me “Ankim ndaj vendimit të shfuqizimit të drejtuesit të Prokurorisë”, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi, duke parashtruar kundërshtimet e saj, në mënyrë të përmbledhur si vijon.

- Vendimi i shfuqizimit është marrë në kundërshtim me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ka vendosur shfuqizimin e procesverbalit të njohjes së të pandehurit me aktet e dosjes dhe akte të tjera të papërcaktuara, të cilat sipas ankimit janë akte të cilat nuk mund të shfuqizohen. Bazuar në këtë dispozitë, prokurori më i lartë mund të shfuqizojë vetëm vendimin për pushimin e procedimit ose dërgimit të tij për gjykim dhe jo akte të tjera.
- Në vendimin e shfuqizimit është arsyetuar se veprimet hetimore janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore pa qenë i deleguar me shkrim nga prokurorja, arsyetim që sipas ankimit nuk qëndron pasi oficeri ka qenë i ngarkuar me kryerjen e hetimeve që në momentin e regjistrimit të procedimit penal.
- Drejtuesi i prokurorisë ka arsyetuar se nuk është nxjerrë urdhër për kërkimin e të pandehurit, arsyetim i cili sipas ankimit nuk qëndron pasi vendimi për mosgjjetjen e tij është marrë bazuar në rregullat për njoftimin e të pandehurit të larguar jashtë shtetit. Për njoftimin e tij janë respektuar dispozitat e nenit 142 të Kodit të Procedurës Penale.
- Mosmarrja e një mase sigurimi nuk mund të jetë shkak ligjor për shfuqizimin e vendimit për dërgimin e çështjes për gjykim dhe zvarritjen e hetimeve pasi nuk ka asnjë pengesë ligjore që masa e sigurimit të kërkohet në seancë gjyqësore.
- Në vendimin e shfuqizimit është arsyetuar se gjatë hetimeve paraprake nuk janë kryer një sërë veprimesh hetimore, veprime të cilat, sipas ankimit të paraqitur, nuk janë të domosdoshme dhe nuk ndikojnë në mënyrën e përfundimit të hetimeve të çështjes pasi

mekanizmi i ngjarjes ka qenë i qartë dhe i provuar se është kryer nga i pandehuri. Sa i përket dëshmisë së penaltetit dhe dokumenteve të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit, ato janë kërkuar dhe, duke qenë se institucionet përkatëse nuk i kanë vënë në dispozicion, ato administrohen gjatë gjykimit.

81. Prokurori i Përgjithshëm, më datë 12.03.2015, merr vendimin për mospranimin e ankimit të prokurorit kundër vendimit të drejtuesit të prokurorisë, pasi ishte i pabazuar dhe, si i tillë, nuk mund të pranohej. Në vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm, arsyetohet si vijon: *[...] ankimi është bazuar në një analizë të pjesës arsyetuese të vendimit të shfuqizimit por pa kundërshtuar në thelb shkaqet kryesore të marrjes së këtij vendimi [...]. Rezulton se shkaqet kryesore të shfuqizimit të vendimit [...] kanë të bëjnë me moskryerjen e hetimeve të plota për ngjarjen e ndodhur, duke lënë si detyrë konkrete pas shfuqizimit të vendimit për dërgimin e çështjes për gjykim, kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, të cilat konsiderohen të rëndësishme në zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes së ndodhur, si dhe në drejtim të individualizimit të përgjegjësive penale dhe shkallës së fajit të personit të pandehur.* *Është e rëndësishme të theksohet se veprimtaria hetimore e policisë gjyqësore dhe e prokurorit në fazën e hetimeve paraprake përfundon në kohën kur çmohet se janë kryer të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme dhe të mundshme për t'u kryer, në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Nga studimi i vendimit të marrë nga drejtuesi i prokurorisë, rezulton se detyrat e lëna në këtë vendim janë të një rëndësie të veçantë për hetimin e plotë të rastit të ndodhur. Po kështu detyrat e tjera janë të domosdoshme për t'u kryer, pasi personi i dyshuar mund të ketë kryer edhe veprime të tjera të kundërligjshme, përveç atyre të pasqyruara në kallëzimin penal të depozituar nga Posta e Shqipërisë ShA.*
82. Sipas arsyetimit të Prokurorit të Përgjithshëm, pretendimi i ngritur se vendimi i shfuqizimit është marrë në kundërshtim me nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, nuk qëndron pasi, me shfuqizimin e vendimit, e humbasin fuqinë e tyre ligjore dhe aktet e lidhura me marrjen e këtij vendimi, të cilat, në përfundim të hetimeve, duhet të ribëhen. Ndërsa lidhur me pretendimet e tjera, si mungesa e delegimit me shkrim të oficerit të policisë gjyqësore, mosnxjerrja e një urdhri kërkimi për personin e pandehur, mosadministrimi në dosje i dokumenteve lidhur me personalitetin e personit të pandehur, si dhe mosmarrja e një mase sigurimi personal, sipas vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm janë pretendime të cilat në thelb nuk cenojnë vendimin e marrë prej drejtuesit të prokurorisë për shfuqizimin e vendimit për dërgimin e çështjes për gjykim, por që as nuk janë konsideruar si bazë për marrjen e këtij vendimi.
83. Lidhur me caktimin e masës së sigurimit personal, trupit gjykues i rezulton se gjatë fazës së hetimeve paraprake të kryera nga prokurorja e çështjes Alketa Nushi, nuk është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal, por pas marrjes së informacionit të Komisarariatit të Policisë Mat, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2015, mbi të dhënat TIMS, nga ana e prokurores është vijuar më datë 19.02.2015 me vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, dhe më datë 23.02.2015, me vendimin “Mbi mosgjetjen e të pandehurit” dhe me vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim, për veprën penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal.
84. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, duke marrë në konsideratë faktin se ishin kryer të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me njoftimin e akuzës, si dhe me njoftimin e akteve të pandehurit, i ka parashtruar edhe drejtuesit të Prokurorisë faktin që masa e sigurimit personal ndaj shtetasit S. Xh. të kërkohej në seancë gjyqësore, pra duke mos qenë kundër caktimit të masës së sigurimit ndaj të pandehurit.

85. Nga analizimi i vendimit të mosgjjetjes së të pandehurit S. Xh., trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka mbështetur këtë vendim, konkretisht në nenin 141, pika 1 dhe në nenin 142, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale. Këto dispozita parashikojnë, si vijon:

Neni 141, i titulluar “Njoftimi i të pandehurit kur nuk gjendet”, pika 1:

*1. Kur njoftimi nuk mund të bëhet sipas rregullave të caktuara për njoftimin e të pandehurit të lirë, autoriteti procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Në qoftë se kërkimi nuk jep rezultat pozitiv, atëherë nxirret vendimi i mosgjjetjes, me të cilin, pasi i caktohet njëmbrojtës të pandehurit, urdhërohet që njoftimi të bëhet duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit. I pagjeturi përfaqësohet nga mbrojtësi. [...].*

Neni 142, i titulluar “Njoftimi i të pandehurit jashtë shtetit”, pika 2:

*[...] 2. Kur del se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vepruar sipas paragrafit 1, autoriteti procedues, para se të nxjerrë vendimin e mosgjjetjes, urdhëron të bëhen kërkime edhe jashtë territorit të shtetit sipas rregullave të caktuara në marrëveshjet ndërkombëtare”.*

86. Referuar këtyre dispozitave ligjore, vendimi i mosgjjetjes së të pandehurit nxirret pasi është urdhëruar kërkimi dhe kur ai nuk ka rezultuar pozitiv. Në kushtet kur nuk ka një urdhër kërkimi ndërkombëtar të nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit për të pandehurin, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim se *njoftimi për këtë të pandehur është bërë në përputhje me nenin 142 të Kodit të Procedurës Penale pasi nga verifikimi i sistemit TIMS, ishte larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë*, rezulton i pabazuar.
87. Në kushtet kur sipas të dhënave të sistemit të hyrje-daljeve (TIMS) në Republikën e Shqipërisë, shtetasi S. Xh. ka rezultuar të ndodhet jashtë vendit, në zbatim dhe të parashikimit të Kodit të Procedurës Penale, neni 228, pika 3, germa b, sipas të cilit masat e sigurimit personal vendosen, *kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet*, subjekti i rivlerësimit megjithëse ka rënë në dijeni të faktit se i dyshuari është larguar jashtë vendit, pas marrjes së informacionit nga Komisariati i Policisë Mat me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2015, nuk e ka vlerësuar këtë element si një fakt që duhet ta çonte drejt kërkesës për caktimin e një mase sigurimi ndaj tij. Duket nga dinamika e ngjarjes se i dyshuari sapo ka përvetësuar shumën e parave, është larguar nga vendi, tipikisht për t’iu shmangur hetimit dhe ky rast përbën rrethanën që duhej të vlerësohej në këtë kontekst. Përkundrazi, prokurorja e ka trajtuar largimin e tij jashtë vendit thjesht si mosgjjetje në vendbanimin e tij, rrethanë e cila shërben në rastet kur i pandehuri apo i dyshuari hetohet në gjendje të lirë sepse nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi. Rasti konkret duket se është tipikisht ai në të cilin duhej të ishte kërkuar caktimi i masës së sigurimit, për pasojë mosveprimi i saj në këtë drejtim, konsiderohet se përbën një shfaqje të mangësive të saj profesionale.
88. Lidhur me pretendimin e subjektit se nga dosja gjyqësore me nr. {\*\*\*}, datë 23.04.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat nuk ka një urdhër kërkimi për të pandehurin, pavarësisht se një nga shkaqet e shfuqizimit të vendimit të subjektit ka qenë mungesa e urdhrat të kërkimit për këtë të pandehur, të cilën dhe gjykata nuk e ka gjetur të metë procedurale pasi, ashtu sikundër pretendon subjekti, njoftimi për këtë të pandehur është bërë në përputhje me nenin 142 të K.Pr.Penale, nga analizimi i akteve të dosjes, rezulton se në seancën gjyqësore të datës 29.05.2015, prokurori i çështjes A. M. kërkoi të caktohet masë sigurimi për të pandehurin S. Xh.. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 26.06.2015, prokurori A. M. deklaroi: *Kemi kërkesë për caktim mase sigurimi “Arrest në burg”, në ngarkim të të pandehurit S. Xh.. Nuk është caktuar masë sigurimi gjatë hetimit pasi kemi pasur mendime të ndryshme gjatë hetimit.* Po sipas procesverbalit të kësaj seance, gjyqtari A. K. rezulton t’i ketë kërkuar *prokurorisë se pse nuk është caktuar masë sigurimi gjatë hetimit pasi nuk kanë*

*ndryshuar rrethana gjatë kësaj kohe. Në momentin që ka ikur (i referohet të pandehurit), duhej të ishte shpallur në kërkim.*

89. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin e ndërmjetëm nr. {\*\*\*}, datë 26.06.2015, vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat (prokuror A. M.) dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” në ngarkim të të pandehurit S. Xh.. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2016, dërgon pranë Prokurorisë së Përgjithshme *urdhër kërkimi ndërkombëtar* për arrestimin e shtetasit S. Xh., si dhe dokumentacionin që bën fjalë për ekzekutimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
90. *Lidhur me faktin e pretenduar nga subjekti se, edhe pas shfuqizimit, dosja penale është dërguar për gjykim në të njëjtën akuzë, me të njëjtat fakte, me të njëjtat prova, me akte të përpiluara dhe nënshkruara nga subjekti, dhe i pandehuri është deklaruar fajtor për të njëjtën akuzë si ajo e ngritur nga subjekti, për të njëjtat fakte penale dhe bazuar në të njëjtat prova si ato të mbledhura nga subjekti gjatë fazës së hetimeve paraprake, trupi gjykues konstaton se dhe pas shfuqizimit të vendimit të datës 23.02.2015 për dërgimin e çështjes për gjykim, përsëri kryerja e veprimeve hetimore u la nën drejtimin e prokurores të ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal Alketa Nushi, e cila do të bënte dhe ndarjen konkrete të detyrave. Fakti që nga prokurori i çështjes bëhet cilësimi juridik i drejtë i faktit penal nuk e përjashton atë nga detyrimi për të kryer hetime të plota e të gjithanshme dhe për të zbatuar drejt parashikimet e ligjit procedural penal.*
91. Për dosjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit S. Xh., nga trupi gjykues u evidentuan mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes, si dhe në drejtim të ndërmarrjes së hapave proceduralë lidhur me njoftimin dhe kërkimin e të pandehurit, si dhe në drejtim të vlerësimit në përputhje me ligjin të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Trupit gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa i përket procedimit penal në ngarkim të shtetasit S. Xh., nuk arritën të ishin bindëse.
92. Shkeljet e konstatuara në dosjet penale të trajtuara në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale në këtë vendim, marrin kuptim e tjetër peshë në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Ato duket se u japin besueshmëri dyshimeve të hedhura në kuptim të këtij procesi dhe afektojnë në këtë mënyrë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, si një indikator i rëndësishëm i kriterit të aftësive profesionale. Në vlerësimin e Kolegjit, nga analiza e shkeljeve të analizuara dhe informacioneve ndonëse të pakonfirmuara të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, përftohen perceptime të rëndësishme se integriteti i subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, do të duhej të konsiderohej me mangësi.
93. Në përfundim të vlerësimit të këtij kriteri, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet që duhet vlerësuar si i papërshtatshëm, sipas parashikimit të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se ka treguar cilësi të papranueshme në punë në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund t’i rikuperojë ato.

*Mbi cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*

94. Komisioni në vendim, ka arritur në konkluzionin se: *nga vlerësimi tërësor dhe kryesisht për sa i takon aspektin etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e*

*publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

95. Në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë nuk vjen si logjikë e natyrshme e pjesës arsyetuese të vendimit të Komisionit, pasi nuk është arsyetuar se si është cenuar besimi i publikut nga subjekti i rivlerësimit. Në mbështetje të pretendimit të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, citon qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën<sup>14</sup> e tij.
96. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se vetëm në paragrafin e fundit të faqes 21, Komisioni shprehet mbi cenimin e besimit të publikut: *Komisioni çmon se nga një vlerësim tërësor i të gjitha problematikave të pasqyruara deri këtu në lidhje me të tria kriteret, të cilat ndërthurin: deklarime të pamjaftueshme në ILDKPKI; mosdeklarimin e plotë në tatime të xhiros vjetore reale të biznesit të familjes; dyshime të arsyeshme për integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara nga informacioni i konsultuar/lexuar nga anëtarët e trupit gjykues, por jo të provueshme plotësisht; mangësitë profesionale të përsëritura dhe dyshime të arsyeshme për favorizime të personave nën hetim, për bënë shkaqe të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut në figurën e prokurorit dhe, më gjerësisht, në sistemin e drejtësisë. Për rrjedhojë, në rastin konkret, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
97. Trupi gjykues vlerëson se zbatimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si një nga rastet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, vjen kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet të ekzistojnë shkelje ligjore të cilat nuk përbëjnë shkak për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61 të këtij ligji. Përderisa shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ato nuk mund t'i ngarkohen rishtazi subjektit edhe në kuptim të nenit 61, pika 5, pasi do të cenonin parimin e mosndëshkimit dy herë për të njëjtën vepër. Duke qenë se nuk ka elemente të tjera që mbeten për t'u vlerësuar nën frymën e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me konsideratë edhe jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, e gjen të paargumentuar aplikimin në këtë çështje të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
98. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, arsye për të cilën vendimi nr. 172, datë 27.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

---

<sup>14</sup> Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 28, datë 23.10.2020, paragrafi 17.4; dhe nr. 31, datë 18.11.2020, paragrafi 50.

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 172, datë 27.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.06.2021.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

Ne, gjyqtaret Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores, dhe Rezarta Schuetz, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, kemi votuar pro *vendimit* nr. 16 (JR), datë 23.06.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 49/2019, datë 09.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 172, datë 27.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), por nuk jemi dakord me vlerësimin e shumicës së trupit gjykues sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë, konkretisht, konkluzioneve për të ardhurat e bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit privat.

### 1. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit privat, Komisioni ka arritur në konkluzionet se:

- subjekti dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklarime të pamjaftueshme vjetore për periudhën 2009 – 2015, duke deklaruar të ardhura neto më të larta nga sa ka rezultuar nga dokumentacioni provues i administruar nga Komisioni;
- Komisioni vlerëson se pasi janë analizuar dhe përllëgoaritur të gjitha faturat e paraqitura nga vetë subjekti – për të provuar xhiron e biznesit të bashkëshortit të vet – ka rezultuar se deklaratimet e të ardhurave, të kryera pranë organeve tatimore nga ky biznes, nuk përkojnë me ato reale, pasi, së paku në tre vjet (2009 – 2011), nuk janë deklaruar, për efekt të tatimeve mbi 3,6 milionë lekë. Ky konkluzion bazohet në faktin që totali i shumave të deklaruara në këta tre vjet, si qarkullim vjetor, rezulton në vlerën 5.224.400 lekë, ndërkohë që shumatorja e faturave të paraqitura nga subjekti, si xhiro vjetore e këtyre viteve, arrin në një total prej 8.914.000 lekësh, pra, me një diferencë të padeklaruar dhe të patatuar prej 3.689.600 lekësh;
- trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria e dyfishtë dhe e përsëritur e deklaratimeve të të ardhurave nga biznesi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, trajtuar më lart, së bashku me pamjaftueshmëritë e deklaratimeve të disa pasurive të vetë subjektit, të deklaruara në deklaratën “vetting” dhe ndërvite, na çon në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit 84/2016.

### 2. Në raportin e administruar nga Komisioni, **ILDKPKI-ja**<sup>15</sup>, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, ka konstatuar se:

- nuk është i saktë deklarimi ndër vite lidhur me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit.

### 3. Në vendimin nr. 16 (JR), datë 23.06.2021, shumica e trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me të ardhurat objekt analizimi, ka dalë në përfundimet:

- trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos marrë në konsideratë të ardhurat sipas faturave të thjeshta tatimore të depozituara nga subjekti, të cilat nuk janë deklaruar pranë organeve tatimore, sipas legjislationit tatimor në fuqi dhe që nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.
- [...] Në kushtet kur, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të ardhurat nga aktiviteti ekonomik i ushtruar nga bashkëshorti, si dhe vetë fakti që të ardhurat sipas faturave të thjeshta tatimore për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzionin që nuk kanë shërbyer për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve, si dhe duke konsideruar mungesën negative – 294.390 lekë të pamjaftueshme për ta ngritur në shkak shkarkimi,

<sup>15</sup>ILDKPKI – akronim për Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.



shumica e trupit gjykues në Kolegj vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e aplikimit të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4. Ne, gjyqtaret Mulaj dhe Schuetz, kundërshtojmë vendimin më sipër të shumicës, me arsyetimin:

- *Së pari*, ka mospërputhje mes të ardhurave nga aktiviteti ekonomik privat i personit fizik "A. N. për vitet 2008-2016, deklaruar në total nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. N., në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë, *vetting (shtojca 2, 2017)*, në shumën 2.359.476 lekë, ndërsa në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2009-2016, deklaruar në total, të ardhura nga aktiviteti privat në shumën 6.892.573 lekë. (Referuar bilancit të pacertifikuar, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në cilësinë e provës, rezultati financiar për vitin 2008, tregon humbje nga aktiviteti ekonomik në shumën 8.836 lekë).
- *Së dyti*, nga analizimi i shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë<sup>16</sup>, rezulton që subjekti "A. N. , me NIPT {\*\*\*}, të mos ketë deklaruar qarkullim vjetor për vitet 2007-2012, fitim apo fitim pas tatimit për të njëjtën periudhë, ndërkohë që për vitet 2013-2016, ka realizuar në total fitim neto në vlerën 909.973 lekë. Pra, nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor sa pretendon subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit për periudhën 2009-2016.

5. Sa u takon *faturave të thjeshta tatimore për periudhën 2009-2012*, depozituar në Komision nga subjekti i rivlerësimit për të *sqaruar faktin që për disa vite janë deklaruar të ardhurat bruto dhe jo ato neto, kështu që trupi gjykues ka pasur detyrimin ligjor t'i përfshijë të gjitha faturat tatimore në analizën financiare për të përcaktuar të ardhurat neto të bashkëshortit (të subjektit) për periudhën më sipër, arsyetojmë:*

- *Së pari*, barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit lidhur me të dhënat për aktivitetin e ushtruar nga personi i lidhur, i përket subjektit të rivlerësimit (neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016). Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, nuk rezultoi të jetë depozituar nga subjekti dokument justifikues ligjor/financiar që të provojë fitimin neto të realizuar nga aktiviteti ekonomik i subjektit tregtar "A. N. për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të secilit vit përkatësisht.
- *Së dyti*, në përgjigje të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, nisur nga përcaktimet e pikës 4.5 të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", nenit 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar si dhe nenit 47 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"<sup>17</sup>:
  - *tatimpaguesi duhet të deklarojë çdo vit para datës 31 mars qarkullimin e tij të përgjithshëm për vitin e kaluar, nga të gjitha bizneset që përfshihen në objektin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, sipas "Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin" , bashkangjitur këtij udhëzimi;*

<sup>16</sup> Në përgjigje të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.04.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.05.2018

<sup>17</sup> Referuar nenit 47 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit "Për taksën vendore të biznesit të vogël", për përlogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apokupona tatimorë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe dispozitat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

- *tatimpaguesi duhet të deklarojë gjithashtu brenda datës 31 mars edhe qarkullimin e parashikuar për vitin në vijim, sipas formularit "Deklaratë Parashikuese e Qarkullimit për Biznesin e Vogël" {\*\*\*}.*

Si dhe:

*Për qëllimet e këtij tatimi, tatimpaguesi duhet të mbajë regjistrimet dhe dokumentet që vijojnë:*

- *dokumentet e blerjes, ku përfshihen [...], **fatura të thjeshta**, dëftesa tatimore etj., për të vërtetuar blerjet e kryera;*
- *dokumentet e shitjes, **fatura të thjeshta tatimore**, dëftesa tatimore dhe përmbledhëset ditore të arkës regjistruese (për shitjet me arkë);*
- *librin e blerjeve; dhe*
- *librin e shitjeve.*

*Në fund të çdo dite pune, tatimpaguesi duhet të regjistrojë në librin e blerjeve totalin e blerjeve që ka bërë atë ditë, si edhe shpenzime të tjera që mund të ketë kryer, si pagesë qiraje, elektriciteti, paga etj.*

*Në librin e shitjeve, në fund të çdo dite pune, tatimpaguesi duhet të regjistrojë totalin e vlerës së shitjeve të realizuara prej tij, duke i grupuar respektivisht në shitje me faturë të thjeshtë tatimore, shitje me arkë regjistruese (totali ditor i kasës) dhe shitje me dëftesa tatimore.*

*Jo më vonë se data 5 e çdo muaji, tatimpaguesi duhet të ketë llogaritur dhe mbyllur totalin e blerjeve dhe të shitjeve për muajin e kaluar. Tatimpaguesi nuk lejohet të grisë apo zëvendësojë faqet e librit të blerjeve apo të shitjeve, apo faqet e blloqeve të faturave të thjeshta tatimore apo dëftesave tatimore.*

Nga sa parashikojnë dispozitat ligjore cituar më sipër, personi fizik "A. N. duhet të kishte deklaruar në organet tatimore qarkullimin/xhiron për çdo vit të periudhës 2009-2012, që konsiston në totalin e të ardhurave nga shitjet, përlllogaritur sipas faturave të thjeshta tatimore, të cilat subjekti i ka depozituar në Komision në cilësinë e provës, dhe t'i kishte regjistruar ato në librat përkatës.

- *Së treti, nga analizimi i të dhënave sipas dokumentacionit justifikues ligjor, nuk rezulton të ketë qarkullim të deklaruar për periudhën 2009-2012, ndërsa nga shumatorja e faturave të thjeshta tatimore rezulton që qarkullimi i padeklaruar nga personi i lidhur për këtë periudhë të jetë në shumën 10.513.671 lekë. Të dhënat e dokumentacionit justifikues ligjor tregojnë që qarkullimi vjetor i deklaruar për vitin 2013 (1.954.945 lekë), të jetë më i vogël se qarkullimi i përlllogaritur si shumatore e faturave të thjeshta tatimore depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision për këtë vit (1.597.976 lekë). Pra, vetë subjekti i rivlerësimit, me aktet e depozituara në Komision, provon se personi i lidhur nuk ka deklaruar në tatime xhiron/qarkullimin real të realizuar nga aktiviteti ekonomik i tij vitin konkret. Për vitet 2014 dhe 2015, qarkullimi i përlllogaritur sipas faturave të thjeshta, është më i vogël se i deklaruar, ndryshe nga viti 2016, në të cilin thuhet përputhet qarkullimi i përlllogaritur me të deklaruarin nga personi fizik në organet tatimore. Në përmbledhje, nga sa më sipër analizuar, dalim në përfundimin se ka mospërputhje mes qarkullimit vjetor të përlllogaritur nga faturat e thjeshta tatimore dhe atij të deklaruar nga personi i lidhur me subjektin në organet tatimore për periudhën 2009-2016.*

Për sa konstatuar më sipër, sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 3 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar:

3. *Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.*

Si shumatorët e faturave tatimore, ashtu edhe dokumentacioni justifikues ligjor, tregojnë që personi fizik "A. N. , me NIPT {\*\*\*}, të ketë pasur qarkullim vjetor më të vogël se 8.000.000 lekë, dhe duhet t'i ishte nënshtruar detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.

Konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor nga zyra e taksave të bashkisë për të provuar qarkullimin e pretenduar, ndërsa në ankim arsyetohet se *bashkëshorti i saj ka qenë i regjistruar si person fizik dhe sipas shkresës nr. {\*\*\*}, datë 28.10.2016, të Bashkisë Tiranë, paraqitur me deklaratën për rivlerësimin e pasurisë (vetting), subjekti "A. N. , me NIPT {\*\*\*}, ka likuiduar detyrimet për taksën e biznesit të vogël nga viti 2008 deri në vitin 2012, sipas qarkullimit vjetor në nivelet nga 0 (zero) deri në 2.000.000 lekë (dy milionë), pra detyrimet tatimore janë paguar në mbështetje të plotë me ligjin tatimor dhe nuk është e kuptueshme për subjektin, se si trupi gjykues ka arritur në përfundim të gabuar.*

Referuar pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar:

1. *Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milionë lekësh, jepet në aneksin 5, që i bashkëlidhet ligjit. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë, përjashtuar rastet e ambulantëve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të njëjtin aneks, që i bashkëlidhet këtij ligji.*

Qarkullimi vjetor për vitet 2009 dhe 2011, i përlogaritur si shumatore e faturave të thjeshta tatimore për secilin vit, ka qenë në shumat 3.276.524, 46 dhe 3.234.370 lekë përkatësisht, pra, brenda fashës 2-5 milionë lekë dhe jo 0-2 milionë lekë si pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim. Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, niveli i detyrimeve fiskale për këtë fashë do të ishte i ndryshëm nga ai i fashës 0-2 milionë lekë. Në kushtet kur personi i lidhur nuk ka deklaruar qarkullimin real të realizuar, i është shmangur vlerësimit fiskal sipas kësaj fashe.

#### 6. Në përmbledhje:

- fakti që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk deklarojnë në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të ardhura në përputhje me dokumentacionin justifikues ligjor, kur referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, këto deklarime *mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji;*
- fakti që ka mospërputhje mes deklarimeve të të ardhurave nga aktiviteti privat i personit fizik "A. N. , deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, *vetting*, dhe të ardhurave nga ky aktivitet, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2009 – 2016;
- fakti që subjekti i rivlerësimit pretendon të ardhura të përfituara nga aktiviteti privat i personit fizik "A. N. , ndërkohë që personi i lidhur, bashkëshorti i saj, nuk ka deklaruar në organet tatimore qarkullimin real vjetor të realizuar nga ky aktivitet ekonomik prej vitit 2009 e në vijim, si rezulton nga analizimi i faturave të thjeshta tatimore, duke iu shmangur kështu detyrimeve tatimore, dhe përfituar në këtë mënyrë të ardhura të patatuara për periudhën 2009-2013, të cilat nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, e të vlerësuara të paligjshme, nuk janë konsideruar në analizën financiare të kryer në Kolegji, ashtu si edhe në Komision;
- fakti që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndodhur në kushtet e evazionit tatimor
  - ne gjyqtaret në pakicë, çmohet se gjithë sa sipër, duhet të ishin marrë në konsideratë në vlerësimin e çështjes nga ana e shumicës së trupit gjykues, pasi subjekti i rivlerësimit në gjykimin tonë, ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 35, pika 5, germa "ç" e ligjit nr. 84/2016, pasi ka bërë deklaram të rremë si në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë, *vetting*,

në deklaratat e interesave privatë periodikë 2009 e në vijim, gjë që vërtetohet me prova (fatura të thjeshta tatimore) të depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*